

ENTI RREGULLATOR I UJIT



RAPORTI VJETOR

2013

Publikuar nga:

Enti Rregullator i Ujit (ERRU)
Blv. Gjergj Fishta, Nr. 10
Tiranë, Shqipëri

E-mail: public@erru.al
Tel. : 00355 4 2258046
http: www.erru.al

© Enti Rregullator i Ujit (ERRU)
Janar 2014



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË
DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA

RAPORTI VJETOR 2013

VEPRIMTARIA E ENTIT RREGULLATOR TË UJIT

DHE

GJENDJA NË SEKTORIN UJËSJELLËS - KANALIZIME

Janar, 2014

Përmbajtja

Fjala Hyrëse	faqe 4
1. Veprimtaria vjetore e Entit Rregullator te Ujit	7
1.1 Të përgjithshme.....	7
1.2 Veprimtaria rregullatore dhe monitoruese.....	9
• Licencimi.....	9
• Tarifat.....	10
• Monitorimi i performancës së sektorit dhe ofruesve të shërbimit.....	17
• Konsumatori dhe transparenca.....	18
• Standarte dhe manuale.....	19
1.3 Konsolidimi institucional.....	21
• Bashkëpunimi me Institucionet në Shqipëri.....	21
• Bashkëpunimi i ERRU me Institucione Ndërkombëtare.....	23
1.4 Të ardhurat dhe shpenzimet e ERRU.....	24
• Burimet e financimit të veprimtarisë	24
• Shpenzimet operative.....	25
• Realizimi i shpenzimeve.....	26
• Pagesa rregullatore vjetore.....	27
2. Gjendja në sektorin ujësjellës kanalizime	28
2.1 Pronësia e operatorëve dhe shërbimet e ofruara.....	28
2.2 Mbulimi me shërbime ujësjellës e kanalizime.....	30
2.3 Kostot për shërbimet ujësjellës e kanalizime.....	31
2.4 Performanca e operatorëve në shërbimet ujësjellës e kanalizime.....	34
3. Objektivat e ERRU per vitin 2014	38
4. Rekomandime	40
Anekset	42

SHKURTIMET

ERRU	-	Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujrave të Ndotura
KKRR	-	Komisioni Kombëtar Rregullator
GIZ	-	Agjensia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
KFW	-	Banka Gjermane për Zhvillim
DPUK	-	Drejtoria e Përgjithshme Ujësjetllës Kanalizime
MTI	-	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
MM	-	Ministria e Mjedisit
MSH	-	Ministria e Shëndetësisë
ISHP	-	Instituti i Shëndetit Publik
USAID	-	Agjensia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar
SHUKALB	-	Shoqata Ujësjetllës Kanalizime e Shqipërisë
UK	-	Ujësjetllës Kanalizime
TKP	-	Treguesit Kryesorë të Performancës
O&M	-	Operim-Mirëmbajtje

Fjala Hyrëse

I dashur lexues,

Raporti Vjetor 2013 që keni në duar prezanton zhvillimet kryesore në sektorin ujësjellës kanalizime në Shqipëri si dhe punën e rezultatet e Entit Rregullator të Sektorit Ujësjellës Kanalizime për përmbushjen e objektivave të tij.

Ky raport synon të analizojë sektorin ujësjellës kanalizimeve në tërësi si dhe të paraqesë aktivitetin e institucionit të pavarur rregullator në përmbushje të detyrimeve që i ka caktuar ligji.

Viti 2013 shënoi 15 vjetorin e krijimit të Entit Rregullator në Sektorin Ujësjellës Kanalizimeve. Në një dekadë e gjysëm Enti është dashur të krijojë statusin e vet të pavarur, të rrisë kapacitetet teknike dhe profesionale dhe të përballojë një sfidë kaq të rëndësishme për rregullimin e shërbimeve jetike si ai i ujit të pijshëm dhe kanalizimeve në të gjithë territorin.



Enti Rregullator i Ujit në Shqipëri (ERRU) në përmbushje të misionit të tij “garantimi për të gjithë shqiptarët që shërbim ofruesit e ujësjellës kanalizimeve të ofrojnë cilësinë më të lartë të mundshme me një çmim të drejtë dhe në një mënyrë financiarisht të qëndrueshme”, duke garantuar në të njëjtën kohë që “sektori i UK të jetë financiarisht i qëndrueshëm, duke i ofruar të gjithë klientëve shërbime me cilësi të lartë por dhe të përballueshme financiarisht”.

Krijimi i një mjedisi rregullator, ligjor dhe transparent është fokusi i punës sonë dhe në këtë kontekst, ERRU nga viti në vit ka mbështetur politikbërësit në reformat e herëpashershme në sektorin e ujësjellës kanalizimeve duke u kthyer kështu në një rregullator të qëndrueshëm për tregun, operatorët, pronarët e tyre dhe mbi të gjitha për konsumatorët të të gjitha kategorive (familjarë, biznese apo institucione publike) qofshin ato.

Enti Rregullator i Ujit drejtohet nga një organ kolegjal në përbërjen e të cilit ushtrojnë funksionin e anëtarët në Komisionin Kombëtar Rregullator 5 anëtarë me kohë të plotë. Përgjegjshmëria dhe përkushtimi ndaj këtij funksioni ligjor ka bërë që komisioni të zhvillojë në mënyrë profesionale 30 mbledhje komisioni gjatë të cilave janë marrë 50 vendime për dhënie licencash dhe miratim tarifash për shoqëritë UK, si dhe miratim të disa instrumentave të rëndësishme rregullatore.

ERRU ka realizuar një sërë aktivitete për përmbushjen e misionit të saj dhe ka zhvilluar një sërë instrumentesh në vitet e fundit për ngritjen e një kuadri rregullator, brenda të cilit

shoqëritë UK të mund të realizojnë shërbimet e tyre dhe në të njëjtën kohë të kenë stimuj për përmirësimin e performancës në kohë.

Licencimi i shoqërive aktive në sektorin e ujësjellës kanalizimeve është një nga funksionet natyrore të ERRU. Gjatë gjithë këtyre viteve Enti është munduar të fusë në pjesën formale të ushtrimit të aktivitetit ofrim të ujit të pijshëm dhe trajtim të ujërave të zeza nga operatorët (kryesisht në pronësi të njësisve të pushtetit vendor) në pjesën formale të tregut. Në fund të vitit 2013 shënohen 54 shoqëri që kanë një liçencë të miratuar nga ERRU. Është për t'u theksuar fakti se gjatë këtij viti janë licencuar 4 shoqëri ujësjellës kanalizime për herë të parë, duke përmirësuar kështu numrin e shoqërive që punojnë në kushte konform ligjit dhe dy shoqëritë tjera janë licencuar për trajtimin e ujërave të ndotura. Aktualisht, 54 shoqëri ujësjellës kanalizime ofrojnë shërbim të licencuar.

Jo vetëm licencimi por edhe forcimi i kushteve të licencimit dhe monitorimit të këtyre kushteve nga ana e rregullatorit ka qënë objektiv i punës gjatë vitit 2013. Për rrjedhojë Enti ka rishikuar kushtet e liçensimit dhe po punon ngushtësisht nën asistencën e GIZ për të rritur rolin e tij monitorues në këtë drejtim.

Për të dytin vit rradhazi ERRU vlerëson ecurinë e sektorit dhe shpall performancën e të gjitha shoqërive të licencuara nga ai (duke theksuar ecuritë më pozitive dhe më negative ndër to). Raporti është një dokument publik, transparent që i vjen në ndihmë jo vetëm shoqërive dhe politikbërësve por mbi të gjitha konsumatorëve direkt të cilët kuptojnë se çfarë përfaqëon tarifa që ata paguajnë kundrejt shërbimeve që ata marrin dhe cila është cilësia e ujit që u ofrohet atyre.

Deri në vitin 2013, 44 shoqëri ujësjellës kanalizime përdorin tarifa të miratuara nga Enti Rregullator i Ujit (ERRU), ndër të cilat 9 u miratuan në vitin 2013. Tarifat janë të miratuara tashmë në bazë të një metodologjie që përdoret gjerësisht në botë e përshtatur me kushtet dhe politikat e tregut shqiptar. Sektori gjatë vitit përveç formalizimit shënon edhe përmirësim të situatës së shoqërisë ujësjellës kanalizime dhe përmirësim të ofrimit të shërbimeve të furnizimit me ujë kanalizimeve në vend. E megjithatë zona e mbulimit me këto shërbime nuk është shtuar aspak (as për ujin e pijshëm dhe as për kanalizimet duke ruajtur të njëjtën situatë sikurse edhe ajo e një viti më parë).

Kështu mesatarisht si sektor shoqëritë ujësjellës kanalizim e kanë rritur masën e mbulimit të kostove operacionale (me rreth 7%) dhe atyre totale (me rreth 1.5%)¹ kundrejt vitit 2012, gjë e cila ka shëndoshur ekonomisht shoqëritë por jo detyrimisht ka përmirësuar për mirë administrimin e të ardhurave nga shitja e shërbimeve në fjalë (arkëtimet kanë rënë në mënyrë të ndjeshme me rreth 18% kundrejt vitit 2012). Kryesisht rritja e mbulimit të kostove vjen si rrjedhojë e rritjes së nivelit të tarifës së ujit, duke rënduar më shumë klientët e rregullt të këtyre shoqërive.

¹ Përkatesisht nga 106.3% të kostove totale në vitin 2012 në 112.4% në fund të vitit 2013 dhe nga 82.7% në vitin 2012 në 84% në fund të vitit 2013. Këto janë të dhëna paraprake pasi në shtator 2013 ERRU vlerësoi dhe publikoi gjendjen e sektorit për vitin 2012.

Treguesit e tjerë të performancës si: (i) niveli i matjes së konsumit, (ii) eficiency e stafit, uji pa të ardhura; (iii) cilësia e ujit të pijshëm, kanë njohur përmirësim ose përkeqësime fare të vogla. Kjo nuk tregon përkeqësim të ecurisë së sektorit, por ndoshta reflekton faktin se Enti po përmirëson cilësinë e të dhënave që mbledh për të vlerësuar sektorin duke i kushtuar më shumë rëndësi tashmë verifikimit të të dhënave që merr në analizë.

Nevoja për ngritjen e një baze të dhënash të sakta dhe të besueshme për nivelet e shërbimit dhe menaxhimin e sistemit janë element kyq për një rregullim të sukseshëm të çdo sektori. Për këtë arsye ERRU e sheh te domosdoshëme dhe po ndërmerr përpjekjet e nevojshme për të rregulluar këtë proces të rëndësishëm i cili do të japë një pasqyrë sa më reale të sektorit.

Ky Raport Vjetor do të shërbejë jo vetëm për të dhënë një përmbledhje të veprimtarisë një vjeçare të ERRU-së por edhe një pasqyrim të situatës aktuale të sektorit. Gjithashtu dhënia e rekomandimeve për zhvillimin e mëtejshëm të sektorit të ujit do të jetë mjaft i dobishëm për aktorët kryesorë në sektor.

Dëshiroj të siguroj të gjithë aktorët në sektor, shoqëritë UK dhe të gjithë konsumatorët shqiptarë se ERRU, me të njëjtin përkushtim të dhënë gjatë këtij viti po ashtu edhe në të ardhmen do të ndërmarrë të gjithë përpjekjet për të rritur dhe forcuar pavarësinë, transparencën, profesionalizmin, bashkëpunimin ndër institucional brenda dhe jashtë vendit në mënyrë të tillë që me autoritetin e tij rregullator të krijoj ekuilibrin e duhur midis ofruesve të shërbimit, politikëbërësve dhe konsumatorit.

Avni Dervishi



Kryetar i Entit Rregullator të Ujit

1. Veprimtaria vjetore e Entit Rregullator të Ujit

1.1 Të përgjithshme

Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) është një institucion i pavarur publik, përgjegjës për rregullimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura në nivel kombëtar.

ERRU është ngritur dhe funksionon në bazë të ligjit nr. 8102, dt. 28.03.1996, për “Kudrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura“, i ndryshuar.

Qëllimi kryesor i këtij ligji është vendosja e një kuadri rregullator dhe ngritja e një Enti të pavarur për të garantuar e mbrojtur interesat publike dhe për të krijuar një mjedis transparent ligjor dhe rregullator në sektor.

Vizioni i ERRU është: “Një sektor ujësjellës-kanalizimesh financiarisht i vetë-qëndrueshëm që ofron shërbime të një cilësie të lartë, por të përballeshme, për të gjithë konsumatorët në Shqipëri”.

Misioni i ERRU është: “Të sigurojë të gjithë konsumatorët në Shqipëri, që ofruesit e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të japin cilësinë me të mirë të mundshme, me një çmim të arsyeshëm dhe në një mënyrë të qëndrueshme financiarisht”.


Detyrat e përgjithshme të ERRU janë:

- Të nxisë efikasitetin dhe përdorimin me efikasitet të ujit, duke nxitur dhe përkrahur mbrojtjen e mjedisit dhe cilësinë e ujit;
- Të bëjë të mundur që të licencuarit të financojnë veprimtaritë e autorizuara nga licenca që ka marrë;
- Të mbrojnë interesat e konsumatorëve në lidhje me:
 - çmimet, tarifat dhe kushtet e shërbimit;
 - cilësinë, efikasitetin dhe vijueshmërinë e këtij shërbimi jetik për të gjithë konsumatorët;
 - garantimin e të drejtave për të ankimuar dhe standarteve të shërbimit.
- Të nxisë konkurrencën;
- Të ushtrojë veprimtarinë institucionale në mënyrë transparente dhe të gjejë një ekuilibër të drejtë ndërmjet pjesëmarrësve të këtij sektori, duke respektuar interesat e konsumatorëve, Këshillit të Ministrave, publikut dhe investitorëve.

Enti Rregullator i Ujit udhëhiqet nga Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) që ushtron këto kompetenca të përgjithshme:


- Jep licenca për entet komerciale që janë të angazhuara në kryerjen e shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të përdorura;
- Miraton çmimet dhe tarifat e shitjes së ujit, me shumicë dhe pakicë, tarifat për ujërat e përdorura dhe tarifat e trajtimit të tyre, afatet dhe kushtet e shërbimit të ofruar nga operatorët që sigurojnë ujë për konsum publik, edhe në ato raste kur sistemet e ujësjellës-kanalizimeve kanë kaluar në administrim ose pronësi të njërive të qeverisjes vendore;
- Cakton standarde për programet e investimeve dhe për shitjen e asetëve nga të licencuarit në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, edhe në rastet kur këto sisteme kanë kaluar në administrim ose pronësi të njërive të qeverisjes vendore;
- Krijon dhe garanton zbatimin e standardeve të punës për të licencuarit;
- Inkurajon standarde dhe rregulla uniforme për të gjithë sektorin;
- Përgatit raporte për gjendjen e sektorit për Këshillin e Ministrave dhe Kuvendin si dhe grumbullon informacionin përkatës nga të licencuarit;
- Cakton tarifat e aplikueshme për licencat;
- Vendos sanksione administrative dhe monetare;
- Nxjerr rregulla për të ndihmuar në ushtrimin e kompetencave dhe funksioneve të parashikuara në ligj.

Struktura dhe organika e ERRU është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me vendim nr. 94, datë 30.04.2007, i ndryshuar. Një skemë e kësaj strukture të ERRU është paraqitur më poshtë:



Në përbërje të ERRU janë 5 Komisionerë, 13 nëpunës të administratës dhe 3 punonjës mbështetës. Përbërja e ekipit të ERRU sipas profesioneve është si më poshtë:

Grafiku 1: Përbërja e ekipit të ERRU sipas profesioneve



1.2 Veprimtaria rregullatore dhe monitoruese

- *Licencimi*

Në sektorin ujësjellës kanalizime ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë, trajtimit të ujit të pijshëm, largimin e ujërave të ndotura, trajtimin e ujërave të ndotura ose një prej tyre gjithsej **58** operatorë. Në fund të vitit 2013, lista e shoqërive UK pësoi ndryshime pasi dy operatorët "U Shkodër fshat" sh.a dhe "UK Malësi e Madhe" sh.a u bashkuan në një shoqëri të vetme në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1094, datë 26.12.2013.

Bazuar në ligjin 8102 datë 23.03.1996, i ndryshuar dhe Rregulloren e Licencimit, miratuar me vendim të KKRR nr. 29 datë 08.12.2009, e ndryshuar, çdo person fizik që ushtron aktivitetin e tij në sektorin ujësjellës kanalizime duhet të jetë i licencuar. Me marrjen e licencës personit i jepet e drejta për ofrimin e shërbimeve të sipërpërmendura. Komisioni Kombëtar Rregullator në dhjetor të këtij viti miratoi licencën e re dhe kushtet e licencës si pjesë e pandarë të saj. Kushtet e licencës duhet të zbatohen nga çdo ofrues shërbimi i licencuar.

Në këtë vit kanë aplikuar për pajisje me licencë apo rinovim licencë 31 operatorë ujësjellës kanalizime, nga të cilat pas plotësimit të të gjithë dokumentacionit në përputhje me VKM nr. 958 datë 06.05.2009 dhe Rregulloren e Licencimit janë licencuar 26 operatorë dhe 5 të tjerë janë në proces. Për herë të parë gjatë këtij viti ka aplikuar dhe janë licencuar "Ndërmarrja Ujësjellës Divjakë", "Komuna Bradashesh", "UK Libohovë" sh.a dhe "UK Fushë-Krujë" sh.a. Më poshtë paraqitet grafiku i situatës së licencimit deri në fund të vitit 2013.

Grafiku 2: Situata e licencimit



Ka raste kur njësitë e qeverisjes vendore e kryejnë vetë shërbimin e kanalizimit të ujërave të ndotura dhe nuk e kanë transferuar këtë funksion pranë operatorëve të ujësjellësit në varësi të njësisë përkatëse. Gjithashtu ka raste kur disa njësi vendore nuk e ofrojnë më vetë shërbimin ujësjellës kanalizime dhe e kanë transferuar tek operatorët UK, por këta operatorë kryejnë aktivitetin e tyre duke mos aplikuar dhe marrë miratimin për licencë nga ERRU.

Operatorët "Ujësjellës Delvinë" sh.a, "Ujësjellës Vlorë" sh.a, dhe "Ujësjellës Tepelenë" sh.a kanë shtuar edhe kategorinë e shërbimit të largimit të ujërave të ndotura i ofruar prej shumë vitesh nga vetë njësitë e qeverisjes vendore të këtyre qyteteve. Gjatë vitit 2013 "UK Durrës" sh.a dhe "UK Korçë" sh.a kanë vënë në funksionim impiantet për trajtimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura dhe janë licencuar nga ERRU për këtë shërbim.

Gjatë procesit të aplikimeve për pajisje me licencë apo rinovim licence gjatë vitit 2013, nga ana e operatorëve që operojnë në sektorin UK, u hasën problematika jo të panjohura më parë për ERRU si ndryshimi i drejtuesit ligjor brenda një periudhe shumë të shkurtër (disa herë brenda një viti), vështirësi në gjetjen e një drejtuesi të kualifikuar teknik ose një drejtuesi të dytë për operatorët që kanë në funksionim impiante, probleme me lëshimin e lejeve higjieno-sanitare nga Inspektoriatet e zonave përkatëse, vështirësi për shlyerjen e pagesës së licencimit tek ERRU dhe vështirësi në regjistrim dhe reflektimin e ndryshimeve në QKR.

- **Tarifat**

Në zbatim të ligjit nr. 8102 datë 28.06.1998 “ Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujrave të ndotura”, i ndryshuar, ERRU është autoriteti që miraton tarifat e shërbimeve UK si dhe përcakton metodologjinë e përlllogaritjes së tarifave. Në zbatim të këtij ligji, Komisioni Kombëtar Rregullator me vendimin nr. 28, datë 28.09.2011, ka miratuar “Metodologjinë për vendosjen e tarifave”, ku janë përcaktuar rregullat për aplikimin, shqyrtimin dhe miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimit dhe përpunimit të ujrave të ndotura.

Metodologjia krijon një lidhje direkte ndërmjet ndryshimit të tarifave dhe performancës së operatorëve në mënyrë që efica në ofrimin e shërbimeve në sektor të rritet.

Në zbatim të metodologjisë, procesi i miratimit të tarifave përfshin analizën e kostove dhe performancës, duke i caktuar operatorëve objektiva të arritshme dhe sfiduese për të përmirësuar cilësinë e shërbimit.

Objektivi kryesor i ERRU në procesin e miratimit të tarifave është gjetja e balancës ndërmjet mbrojtjes së interesit të konsumatorëve dhe rritjes së qëndrueshmërisë financiare të ofruesve të shërbimit, ashtu siç parashikohet në Vizionin dhe Misionin e tij.

Komisioni Kombëtar Rregullator në vendimmarrjen e tij është përpjekur që nëpërmjet rishikimit periodik të tarifave të përmirësojë hap pas hapi mbulimin e kostove, duke rritur kështu qëndrueshmërinë financiare të operatorëve, me qëllim uljen e subvencioneve dhe krijimin e mundësive për shlyerjen e kredive.

Tendenca e ndryshimit të tarifave ka qënë gjithmonë në rritje, në varësi edhe të performancës së operatorëve. Gjatë tre viteve të fundit tarifat mesatare, në shkallë vendi, për konsumatorët familjare janë rritur në masën 14 % për shërbimin ujësjellës dhe 25 % për shërbimin e kanalizimeve. Tarifat aktuale të zbatuara gjatë vitit 2013 nga operatorët e këtij shërbimi jepen në aneksin 2 të këtij raporti.

Nëpërmjet rritjes së tarifave është synuar rritja e shkallës së mbulimit të kostove me të ardhurat nga aktiviteti.

Në sektorin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve janë kryer dhe vazhdojnë të kryhen investime kapitale për rehabilitimin dhe zgjerimin e sistemeve të shërbimit, pjesa më e madhe e të cilave janë financuar nga donatorë të huaj nëpërmjet grandeve dhe kredive. Shlyerja e kredive kërkon sigurimin e mjeteve financiare të nevojshme.

Ndërtimi dhe vënia në funksionim e impianteve të trajtimit të ujrave të ndotura si dhe rehabilitimi i kolektorëve të largimit të ujrave të ndotura kanë sjellë jo vetëm përmirësimin e këtij shërbimi por dhe një rritje të konsiderueshme të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes të sistemit të ujrave të ndotura, gjë e cila është reflektuar padyshim edhe në tarifat e këtij shërbimi.

Në vitin 2013, pranë ERRU u paraqitën këto kërkesa për miratim tarife:

"UK Korçë" sha për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujrave të ndotura.

"UK Gjirokastrë" sha, "UK Ersekë" sha, "UK Lezhë" sha, "UK Sarandë" sha, "UK Lushnjë" sha, "UK Fier" sha, "UK Berat-Kuçovë" sha, "Ndërmarrja UK Bashkia Pukë" për ndryshimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujrave të ndotura.

"UK Tepelenë" sha dhe "UK Vlorë" sha aplikuan për miratimin e tarifave të shërbimit të largimit të ujrave të ndotura. Tashmë këta operatorë janë licencuar nga ERRU për kryerjen e këtij shërbimi, i cili më parë kryhej nga Bashkitë përkatëse.

KKRR përfundoi procesin e miratimit të tarifave për aplikimet e paraqitura me përjashtim të "UK Fier" sha, "UK Lushnjë" sha dhe "UK Berat-Kuçovë" sha për të cilat procesi i miratimit të tarifave është shtyrë deri në plotësimin e kërkesave konform Metodologjisë së Tarifave


Vlerësimi i propozimit për ndryshimin e tarifave për secilin aplikim është bërë mbi bazën e analizës së situatës aktuale ekonomike e financiare dhe treguesve kryesorë të performancës, tendencës së tyre, synimeve të operatorit me tarifat e kërkuara si dhe kushteve specifike të operimit.

ERRU nëpërmjet strukturës së miratuar të tarifave për secilën shoqëri ka synuar arritjen e objektivave të politikës tarifore:

Mbulimi i kostos së operimit dhe mirëmbajtjes, për të bërë të mundur që gradualisht të arrihet mbulimi i kostos totale.

Rezultati i pritshëm në mbulimin e kostove të O&M me të ardhurat nga aktiviteti për vitin 2014 krahasuar me dy vitet e mëparshme, për operatorët të cilëve u janë miratuar tarifat, pasqyrohet në grafikun e mëposhtëm:

Grafiku 3: Mbulimi i kostove të operimit dhe mirëmbajtjes




Për vitin 2014, mbulimi i kostos së operimit dhe mirëmbajtjes me të ardhurat nga shërbimet UK (për operatorët e sipërpërmendur) parashikohet të rritet 13% krahasuar me një vit më parë.

Ky përmirësim vjen si rezultat i rritjes së të ardhurave por edhe i kujdesit që operatorët po tregojnë për të mbajtur nën kontroll nivelin e shpenzimeve. Për vitin 2014, kostot O&M për këta operatorë parashikohen të rriten mesatarisht 5% krahasuar me vitin 2013.

Nga ana tjetër të ardhurat do të rriten rreth 15%. Rritja e të ardhurave vjen si rezultat i ndryshimit të tarifave dhe përmirësimit të menaxhimit. Siç shihet edhe nga grafiku, rritja më e madhe vjen si rezultat i rritjes së tarifave.

Grafiku 4: Ndikimi i përmirësimit të menaxhimit dhe tarifave në totalin e të ardhurave



Megjithëse të ardhurat parashikohen të rriten, jo të gjithë operatorët do të arrijnë të mbulojnë koston totale. Kjo kosto parashikohet të rritet ndjeshëm në vitin 2014, rritje kjo që vjen për arsye se koston O&M i shtohen jo vetëm kosto e amortizimit por edhe kosto e kredisë.

Duke analizuar strukturën e koston totale sipas këtyre tre zërave rezulton se ndarja e shpenzimeve për 6 operatorë është:

Tabela 1: Struktura e koston totale

Operatori	Kosto O&M	Amortizimi	Kosto e Kredisë
UK Ersekë sha	86%	14%	0%
UK Gjirokastër sha	95%	5%	0%
UK Lezhë sha	71%	27%	2%
UK Pukë sha	87%	13%	0%
UK Korçë sha	49%	19%	31%
UK Sarandë sha	66%	34%	0%
Mesatarja :	62%	22%	16%


Operatorët që kanë marrë kredi për të kryer investime si "UK Korçë" sha dhe "UK Lezhë" sha janë të detyruar të paguajnë jo vetëm interesat e kredisë por edhe këstin e saj. Këto kosto kanë ardhur duke u rritur nga viti në vit.

Investimet nga njëra anë kanë luajtur një rol të rëndësishëm në përmirësimin e shërbimit për konsumatorët por nga ana tjetër mirëmbajtja e sistemeve UK dhe koston e kredisë e rrisin koston e shërbimeve.

Për "UK Korçë" sha kosto e amortizimit dhe e kredisë zënë 50% të koston totale. Prandaj ndryshimi i tarifave është i nevojshëm dhe i domosdoshëm pasi të ardhurat nuk i përmbushin nevojat e operatorëve për të mbuluar këto kosto.

Në të ardhmen situata do të jetë e ngjashme edhe për operatorët "UK Sarandë" sha, "UK Gjirokastër" sha, "UK Fier" sha, dhe "UK Lushnjë" sha, të cilat janë pjesë e programit të investimeve nga KFW.

Grafiku 5: Mbulimi i koston totale



Me përjashtim të UK Gjirokastër sha, të gjitha shoqëritë e tjera nuk mbulojnë koston totale. Për këtë shoqëri rritja e të ardhurave duhet të shoqërohet me përmirësimin e shërbimit, i cili aktualisht nuk është në nivele të mira. UK Gjirokastër sha duhet të përdorë fitimin për rehabilitimin e rrjetit ekzistues dhe vendosjen e matësave si dhe të akumulojë mjete financiare për shlyerjen e kredisë për investimin që do të financohet nga KFW.

Mbulimi i kostove nuk duhet të arrihet vetëm nga rritja e tarifave por edhe nga përpjekjet sistematike për të ulur kostot e shërbimit duke rritur efikasitetin menaxhues dhe teknik.

Operatorët duhet të shikojnë mundësinë për të ulur shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes sidomos në ato zëra që zënë edhe peshën specifike më të madhe të këtyre shpenzimeve.

Ulja e humbjeve, rritja e nivelit të faturimit, vendosja e matësave, përmirësimi i normës së arkëtimit, rritja e efikasitetit të stafit, përmirësimi i efikasitetit të energjisë janë tregues ku menaxhimi me profesionalizëm luan një rol të rëndësishëm.

Aktualisht ERRU ka përzgjedhur 10 tregues kryesorë (TKP) për të vlerësuar performancën e operatorëve. Këta tregues pasqyrojnë një pjesë të madhe të detyrave që operatorët duhet të kryejnë në mënyrë që shërbimet që ato ofrojnë të jenë cilësore dhe eficientë.

Miratimi i tarifave përfshin si pjesë të këtij procesi edhe përcaktimin e objektivave për 10 TKP që operatori duhet të arrijë për përmirësimin e shërbimit. Përpara çdo ndryshimi të kërkuar të tarifave bëhet vlerësimi i realizimit të këtyre objektivave. Në varësi të rezultateve të arritura procesi i miratimit të tarifave përfshin stimuj për operatorët që kanë përmirësuar performancën e tyre duke ofruar shërbime më të mira ose penalizim për ata që nuk kanë mundur të realizojnë objektivat.

KKRR për dy operatorët "UK Gjirokastër" sha dhe "UK Lezhë" sha analizoi realizimin e objektivave për vitin 2013, të përcaktuara me miratimin paraardhës të tarifave. Nga analiza rezultoi se operatorët nuk i kishin arritur të gjitha objektivat e përcaktuara nga KKRR. Për këtë arsye këta operatorë u penalizuan duke mos iu miratuar ndryshimi i kërkuar i tarifave.

Gjithashtu KKRR me miratimin e tarifave përcaktoi për secilin operator objektivat për 10 TKP për vitin 2014.

Me miratimin e tarifave pritshmëritë janë:

- përmirësimi i Treguesve Kryesorë të Performancës, sipas Aneksit nr.1;
- rritje e nivelit të mbulimit të kostove

Tarifat e reja të miratuara së bashku me investimet kapitale që janë kryer dhe po kryhen në sektor kanë qenë një hap i rëndësishëm në rritjen e qëndrueshmërisë financiare të operatorëve dhe rrjedhimisht në rritjen e cilësisë dhe sigurisë së shërbimit në drejtim të konsumatorëve dhe zhvillimit të sektorit.

Një nga objektivat kryesore të politikës tarifore është përballueshmëria e pagesës së tarifave të ujit nga konsumatorët familjarë.

Megjithëse ka vend për rritje të mëtejshme të tarifave duhet mbajtur parasysh raporti ndërmjet përballimit të tarifave nga konsumatorët dhe arritjes së pavarësisë dhe qëndrueshmërisë financiare të operatorëve. Kjo bëhet edhe më e domosdoshme po të marrim në konsideratë klientët me të ardhura të ulta dhe ata në nevojë.

Për shumë operatorë kostot e shërbimit janë rritur ndjeshëm për arsye të kryerjes së investimeve të domosdoshme për përmirësimin e shërbimeve, dhe veçanërisht për ata operatorë ku impjantet e trajtimit të ujrave të ndotura janë vënë në përdorim. Duke patur parasysh angazhimet që Shqipëria ka për të arritur pajtueshmërinë me direktivat kryesore të BE lidhur me mjedisin, trajtimi i ujrave të ndotura mbetet një fushë prioritare. Duhet theksuar se trajtimi i ujërave të ndotura është një shërbim i kushtueshëm dhe në disa zona i papërballueshëm për disa kategori konsumatorësh familjare.

Në përputhje me Metodologjinë për Vendosjen e Tarifave, shpenzimet për shërbimet UK nuk duhet të zënë më shumë se 5% të të ardhurave familjare.

Tabela e mëposhtme pasqyron se çfarë pjese zë në të ardhurat familjare pagesa për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujrave të ndotura. Kjo përlllogaritje është bërë duke marrë për bazë të ardhurat mesatare mujore² për familje dhe vlerën që do të arrijë fatura e shërbimeve UK për një familje me konsum mesatar (18 m³ në muaj) me tarifën e miratuara.

Tabela 2: Përqindja e vlerës së faturës kundrejt të ardhurave për familje

Operatori		Vlera e faturës (lek/muaj)	Të ardhurat mesatare për familje (lek/muaj)	Vlera e faturës / Të ardhurave %
Sha UK	Ersekë	891	42,464	2.1%
Sha UK	Gjirokastër	942	48,327	2.0%
Sha UK	Korçë	1,940	42,464	4.6%
Sha UK	Lezhë	1,599	47,081	3.4%
Sha UK	Pukë	891	40,865	2.2%
Sha UK	Sarandë	949	48,327	2.0%

Siç shihet edhe nga tabela, raporti i vlerës së faturës kundrejt të ardhurave për operatorin "UK Korçë" sha është mbi 4%. Për të njëjtin nivel konsumi në nivel kombëtar, vlera e faturës zë 3.3% kundrejt totalit të të ardhurave për një familje shqiptare.

² të dhënat për të ardhurat mesatare janë marrë nga INSTAT

Për këtë operator, kostot e shërbimit siç edhe kemi theksuar më parë, kanë ardhur duke u rritur për shkak të kredisë së marrë dhe futjes së shërbimit të trajtimit të ujërave të ndotura. Në përlllogaritjen e tarifave krahas kostos O&M janë marrë në konsideratë edhe kostot e kredive. Bazuar në marrëveshjet përkatëse të kredive ky operator ka filluar të paguajnë kostot e tyre.

Megjithatë është e arsyeshme që së paku një pjesë e kostove të mbulohen përmes tarifave, por mbulimi total i tyre mund të mos jetë i përballueshëm nga klientët dhe rritja e mëtejshme e tarifave mund të sjellë efekte negative.

"UK Korçë" sha krahas shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujrave të ndotura kryen edhe trajtimin e ujrave të ndotura. Për këtë arsye kostot e shërbimit janë rritur, gjë e cila është reflektuar edhe në tarifën e këtij shërbimi. Kjo shoqëri operon me tarifa të larta, shërbimi është mjaft i mirë, konsumatorët janë të kënaqur dhe paguajnë rregullisht për shërbimin e ofruar, por rritja e mëtejshme e tarifave mund të japë efekte negative. Sinjalet e para janë paraqitur. Gjatë dy viteve të fundit vihet re një ulje e nivelit të arkëtimit, ulje e nivelit të konsumit nga konsumatorët dhe për pasojë rritje e nivelit të humbjeve ndonëse në shifra të vogla.

ERRU nëpërmjet metodologjisë aktuale të vendosjes së tarifave është duke përdorur instrumentat e tij për të bërë të mundur që tarifat të jenë të përballueshme për konsumatorët, në veçanti për ata me të ardhura të ulta dhe ata në nevojë. ERRU është e gatshme të bashkëpunojë edhe me aktorë të tjerë për të gjetur zgjidhjen më të mirë të mundshme për mbrojtjen e shtresave me të ardhura të ulta dhe atyre në nevojë.

Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim luan *struktura tarifore*: tarifë fikse dhe tarifë variabël me blloqe konsumi, e cila krijon mundësinë për të paguar më pak për konsum më të ulët. Në kushtet kur skemat e subvencionimit për familjet me të ardhura të ulta nuk janë të përcaktuara, struktura tarifore përcakton një tarifë të përballueshme për nevojat bazë të konsumit për këtë kategori konsumatorësh. Aplikimi i kësaj strukture tarifore kërkon që niveli i matjes të jetë i lartë, në veçanti të gjithë konsumatorët jofamiljarë të jenë pajisur me matës dhe sistemi i faturimit të jetë i kompjuterizuar. Operatorët që aplikuan për ndryshimin e tarifave në vitin 2013 dhe 2014, me përjashtim të "UK Pogradec" sha dhe "UK Korçë" sha nuk kanë mundur të plotësojnë këto kushte. Prandaj struktura e miratuar e tarifave përfshin një "tarifë fikse" për çdo kategori konsumatorësh dhe një "tarifë variabël" për të gjitha blloqet e konsumit.

Metodologjia e kushtëzon rritjen e tarifave vetëm për operatorët që arrijnë të përmirësojnë shërbimin. Klientët janë më të gatshëm të paguajnë kur atyre u ofrohet shërbim cilësor.

Edhe organizimi i *seancës dëgjimore* me publikun sjell informacion mbi pritshmërinë dhe gadishmërinë për të paguar nga konsumatorët, kryesisht ata familjar.

Gjithsesi duhet të gjenden mekanizma të përshtatshme subvencionimi për të bërë të mundur mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë dhe njëkohësisht funksionimin e operatorëve në mënyrë të qëndrueshme.

- *Monitorimi i performancës së sektorit dhe ofruesve të shërbimit*

ERRU monitoron performancën e operatorëve të shërbimit UK për të garantuar përmbushjen e përgjegjësi të tyre dhe për të parë progresin që ata bëjnë për të përmirësuar shërbimet. Rezultatet e monitorimit të performancës përdoren nga ERRU si në procesin e ndryshimit të tarifave si dhe për identifikimin e mundësive për përmirësimin e shërbimit.

Monitorimi jep mundësi për një vlerësim korrekt të performancës së çdo operatori dhe vendosjen e objektivave sfiduese dhe të arritshme si për operatorët me performancë të dobët ashtu edhe për ata që kanë rezultate të mira. Arritjet maten në bazë të Treguesve Kryesorë të Performancës të cilët janë të njëjtë për të gjithë sektorin. Përmbushja e objektivave është thelbësore për operatorët që kërkojnë ndryshim tarifash, pasi atyre u duhet të arrijnë objektivat e vendosur para miratimit të çfarëdolloj kërkesë për ndryshim tarifash.

ERRU ka publikuar dy raporte të performancës së operatorëve ujësjellës kanalizime në sektorin UK, i pari në vitin 2012 dhe i dyti në vitin 2013. Në këto raporte shqyrtohet performanca individuale e operatorëve, e krahasuar edhe me performancën e operatorëve të tjerë. Përmes raportit të performancës vetë operatorët mund të vlerësojnë performancën e tyre duke e krahasuar me atë të operatorëve të tjerë që operojnë në kushte të ngjashme.

Monitorimi i sektorit UK dhe publikimi i raportit të performancës ka për qëllim dhënien e mundësisë për të gjithë aktorët e interesuar, duke përfshirë edhe vetë konsumatorët, të shohin progresin e arritur në këtë sektor dhe të vlerësojnë performancën e operatorit të tyre lokal. Nëpërmjet publikimit të këtyre raporteve, ERRU dëshiron të nxisë të gjithë aktorët, operatorët, pronarët e tyre, këshillat mbikëqyrës, klientët, mediat si dhe vendimmarrësit politikë për tu angazhuar në një dialog konstruktiv mbi sfidat aktuale të sektorit dhe ato në të ardhmen.

Një rregullim i mirë i sektorit ka nevojë për informacion të besueshëm. Saktësia e të dhënave luan një rol të rëndësishëm në përcaktimin e tarifave. Rritja e besueshmërisë së të dhënave është një nga prioritetet e punës së ERRU. Për këtë qëllim gjatë vitit 2013 u kryen disa inspektime për verifikimin dhe saktësimin e të dhënave. Inspektimi u krye sipas një programi të përcaktuar që përfshinte kryesisht inspektimin e të dhënave që lidhen me treguesit kryesorë të performancës.

Në veçanti për tre operatorë që aplikuan për ndryshimin e tarifave "UK Lushnjë" sha, "UK Sarandë" sha dhe "UK Lezhë" sha, inspektimi u bë më i detajuar pasi verifikimi dhe saktësimi i të dhënave ishte i lidhur me ndryshimin e tarifave. Për "UK Lezhë" sha dhe "UK Lushnjë" sha saktësimi i të dhënave lidhej edhe me vlerësimin e realizimit të objektivave të përcaktuar nga KKRR për vitin 2013. Më pas, mbi bazën e rezultateve të inspektimit u bënë edhe korrigjimet përkatëse.

Në vitin në vazhdim monitorimi i të dhënave dhe zbatimi i tarifave të miratuara do të jenë në fokus të punës së ERRU.

- *Konsumatori dhe Transparenca*

Enti Rregullator i Ujit si një institucion rregullator i pavarur, synon ushtrimin e veprimtarisë së tij institucionale në mënyre transparente dhe jo diskriminuese. Ky institucion ka si mision të sigurojë për të gjithë klientët e sektorit ujësjellës kanalizime në Shqipëri një shërbim me cilësinë më të mirë të mundshme dhe me një çmim të arsyeshëm. Për këtë arsye, ERRU e trajton me kujdes të veçantë dhe merr në konsideratë opinionin e konsumatorëve në procesin e ndryshimit të tarifave dhe ndjek me kujdes çdo ankesë që paraqitet nga konsumatorët.

Një moment i rëndësishëm në mbrojtjen e konsumatorit nëpërmjet politikave rregullatore, është Metodologjia për Vendosjen e Tarifave, në të cilën është sanksionuar seanca dëgjimore me publikun dhe prej atëherë ajo është e detyrueshme për tu zhvilluar nga të gjithë operatorët e mëdhenj³ që aplikojnë për ndryshim tarife dhe këshillohet të organizohet nga të gjithë operatorët e tjerë.

Gjatë vitit 2013, "UK Korçë" sh.a. dhe "UK Berat – Kuçovë" sh.a. zhvilluan takime publike me konsumatorë të kategorive të ndryshme dhe përfaqësues të mediave lokale.

Gjatë këtyre takimeve, operatorët informuan publikun, iu përgjigjën pyetjeve të të pranishmëve, parashtuan arsyet se përse operatorët kërkonin ndryshim tarife dhe përmirësimet që pretendohet se do të sjellë në cilësinë e shërbimit ky ndryshim. Nëpërmjet sanksionimit të seancës dëgjimore, ERRU kërkon të sigurohet që konsumatorët të jenë të informuar mbi shërbimin që marrin dhe ndryshimet që mendohet t'i ndikojnë ata në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo në të ardhmen. Për një shërbim monopol, siç është ai i furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, ky moment merr një rëndësi të veçantë.

ERRU shërben si ndërmjetës në procesin e zgjidhjes së ankesave. Bazuar në ligjin nr. 8102, i ndryshuar, çdo person i interesuar mund të dorëzojë Komisionit një ankesë për një operator të licencuar. Për periudhën janar – dhjetor 2013 pranë Entit Rregullator të Ujit janë paraqitur 39 ankesa nga kategori të ndryshme konsumatorësh.

Kryesisht qytetarët i drejtohen ERRU kur nuk janë të kënaqur me përgjigjen e marrë nga operatori që i ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime mbi një problem apo mosmarrëveshje midis tyre. Ankesat vijnë më së tepërmi nga klientë në kryeqytet, megjithëse gjatë vitit 2013 ka edhe disa raste sporadike nga qytete si Durrës, Kavajë dhe Ersekë.

ERRU është vënë në dijeni për shqetësime të qytetarëve edhe nëpërmjet Avokatit të Popullit.

Gjatë këtij procesi, Enti Rregullator i Ujit haset me një vështirësi jo të vogël, pamundësia për të marrë vendime mbi zgjidhjen e ankesave. Kjo ceshtje mund të rregullohet me ndryshime në ligjin nr. 8102, duke synuar mbrojtje më të mirë të të drejtave të konsumatorit.

³ Operatorët e mëdhenj përcaktohen si më poshtë:


- Operatorët që ofrojnë vetëm shërbimin e furnizimit me ujë për një popullsi prej 100 000 banorësh në zonën e tij të shërbimit

- Operatorët që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime për një popullsi prej 50 000 banorësh në zonën e tij të shërbimit

Në shkurt të vitit 2011, KKRR miratoi kontratën model për shërbimet ujësjellës e kanalizime. Nga momenti i miratimit nisi një proces sa i rëndësishëm aq edhe kompleks, ai i zbatimit të kësaj kontrate nga të gjithë operatorët që ofrojnë shërbime në sektor. ERRU gjatë gjithë kësaj periudhe ka monitoruar zbatimin e kësaj kontrate sipas kategorive të konsumatorve.

Deri në fund të vitit 2013 situata e përhapjes së kësaj kontrate paraqitet si më poshtë:

Grafiku 6: Përqindja e zbatimit të kontratës model sipas kategorive të klientëve



Kategoria e klientëve publikë janë më pranë përfundimit duke arritur shifrën prej 79 % të pajisjes me këtë kontratë. Klientët familjarë janë pajisur në masën 33%, ndërkohë që klientët privatë vetëm 44%. Në total, 34 % e konsumatorve në sektorin ujësjellës kanalizime janë pajisur me kontratën model të miratuar nga KKRR.

Nëpërmjet raporteve vjetore dhe të performancës, nëpërmjet publikimeve të të gjithë vendimeve të Komisionit Kombëtar Rregullator, publikimeve të studimeve, rregulloreve, metodikave dhe udhëzuesve, si dhe nëpërmjet faqes së web-it të përditësuar rregullisht, Enti Rregullator i Ujit synon arritjen e transparencës së plotë mbi punën e tij dhe gjendjen e sektorit ujësjellës kanalizime në raport me pushtetin qendror, pushtetin lokal, institucionet e pavarura, të gjithë konsumatorët, partnerët ndërkombëtar dhe donatorët.

- **Standarde dhe manuale**

Një nga kompetencat kryesore të Komisionit Kombëtar Rregullator është inkurajimi i standardeve dhe rregullave uniforme për të gjithë sektorin, krijimi dhe garantimi i zbatimit të tyre nga të gjithë të licencuarit.

Gjatë vitit 2013 Komisioni Kombëtar Rregullator ka ndërmarrë disa iniciativa si më poshtë:

- *Miratimi i Kushteve të reja të licencës*

Kushtet e reja të licencës janë konceptuar si pjesë integrale e Licencës së shërbimit që i bashkëngjitet certifikatës së licencës. Ato janë një përmbledhje e të gjithë detyrimeve ligjore që ka një operator shërbimi në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Keto kushte zërthejnë dhe detajojnë detyrimet dhe të drejtat që operatorët kanë, por që gjenden në shumë akte ligjore e nënligjore dhe që shpesh nuk njihen nga operatorët.

Çështjet kryesore që trajtojnë kushtet e reja të licencimit janë:

- Veprimtaria e të licencuarit
- Kryerja e shërbimit
- Pezullimi dhe heqja e licencës
- Marrëdhënia e operatorit me ERRU

Kushtet e reja të licencës i krijojnë mundësinë ERRU të monitorojë në mënyrë efektive veprimtarinë e operatorëve të shërbimit.

- *Miratimi i Bilancit të Ujit*

Bilanci i Ujit është një dokument që i shërben operatorëve për të vërejtur dhe kontrolluar në mënyrë të vazhdueshme problematikën që ndodh gjatë administrimit të sistemit të furnizimit me ujë në pjesë të ndryshme të tij në mënyrë që të gjejë zgjidhjet përkatëse në një kohë sa më të shkurtër. Bilanci i Ujit duhet të plotësohet çdo muaj nga operatorët e shërbimeve në bazë të të dhënave të matura apo të vlerësuara nga specialistët përkatës që operojnë në terren.

Bilanci i ujit përbleh një informacion në lidhje me:

- sasinë e ujit të prodhuar dhe të furnizuar;
- sasinë e ujit të humbur për shkak të problemeve teknike të sistemit apo matësve të ujit;
- sasinë e ujit të humbur për shkak të lidhjeve të paligjshme apo problemeve të keqadministrimit të sistemit;
- sasinë e ujit të furnizuar tek konsumatorët;
- sasinë e ujit të përdorur për qëllime publike (sistemet kundra zjarrit, pastrimi i rezervuarëve, rrugëve apo ujitja e lulishteve, etj) dhe për institucione të veçanta (kisha, xhami, shtëpitë e fëmijëve, shtëpitë e të moshuarve, etj).

Bilanci i Ujit i plotësuar nga operatorët do të jetë një instrument që do t'i shërbejë vetë atyre në rradhë të parë, si dhe ERRU e njëjësive vendore si pronarëve të këtyre sistemeve për të monitoruar performancën dhe cilësinë e shërbimit të operatorëve.

- *Manuali për vendosjen e tarifave për më shumë se një vit për operatorët që kanë hartuar plan biznesi*

Shumë operatorë kanë hartuar planet e tyre të biznesit si një mjet i rëndësishëm për planifikimin dhe menaxhimin e veprimtarisë së tyre. Hartimi i planeve të biznesit është një parakusht për miratimin e tarifave të shërbimeve UK për më shumë se një vit.

Manuali do të krijojë mundësinë ERRU për të patur informacionin e duhur për marrjen e vendimeve sa më të drejta lidhur me ndryshimin e tarifave për më shumë se një vit.

Ky manual po hartohet në bashkëpunim me konsulencën e GIZ.

- *Manuali i këshillave mbikqyrës të operatorëve*

Enti Rregullator i Ujit me mbështetjen financiare të USAID dhe GIZ në respektim të Strategjisë Kombëtare të Ujit edhe për këtë vit zhvilloi fazën e tretë të trajnimit për Manualin e Këshillave Mbikqyrës së shoqërive ujësjellës kanalizime. Në këtë trajnim morën pjesë anëtarët e këshillave mbikqyrës së 19 operatorëve dhe u zhvilluan në formën e seminareve në tre qytete, përkatësisht Korçë, Shkodër dhe Gjirokastrë.

1.3 Konsolidimi Institucional i ERRU

Gjatë vitit 2013 ERRU ka pasur në fokus të punës konsolidimin institucional të tij për të ushtruar plotësisht rolin dhe përgjegjësitë në sektorin e ujit. Rritja e kapaciteteve duke rritur në mënyrë sasiore dhe cilësore trajnimet, kualifikimet dhe angazhimet në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, ka patur si qëllim përmirësimin e zbatimit të mandatit rregullator.

Forcimi i bashkëpunimit me aktorët kryesorë në sektor ka qënë në qëndër të vëmendjes së ERRU, si një element tepër i rëndësishëm për të realizuar detyrat dhe objektivat rregullatore.

- *Bashkëpunimi me Institucionet në Shqipëri*

Në veprimtarinë ERRU-së, përgjatë vitit 2013 bashkëpunimi institucional si brenda dhe jashtë vendit ka zënë një vend të rëndësishëm. Ky bashkëpunim ka pasur si synim ndërveprimin institucional me qëllim rritjen e efektivitetit dhe cilësisë së shërbimit ujësjellës kanalizime në Shqipëri. Gjithashtu njohja dhe bashkëpunimi më nga afër me eksperiencat e huaja për aspektet rregullatore në sektorin e Ujit ka ndikuar në përmirësimin e kontributit tonë në sektor.

Për vitin 2013 bashkëpunimi ndër institucional ka vijuar me:

- Kuvendin e Shqipërisë
- Këshillin e Ministrave
- Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës (MTI)
- Ministria e Shëndetësisë (MSH) dhe ISHP
- Ministria e Mjedisit (MM)

- Shoqatën e Ujësjiellës Kanalizimeve të Shqipërisë (SHUKALB)
- Avokatin e Popullit
- Autoriteti i Konkurrencës

Pjesëmarrje në Aktivitete pune dhe Konferenca Kombëtare

✓ *Aktivitete të organizuara nga ERRU*

- Workshopi "Aplikimi i Metodologjisë për Vendosjen e Tarifave" ku u diskutua dhe u mblodhën sugjerime nga shoqëritë UK mbi përmirësimet e mundshme të kësaj metodologjie.
- Aktivitete për festimin e 15 Vjetorit të krijimit të ERRU-së ku u prezantua rrugëtimi 15 Vjeçar i ERRU-së, dhe Raporti i Performancës për vitin 2012 i cili bëri të njohur për publikun e gjerë një informacion të detajuar nga analiza e bërë mbi performancën e secilit prej operatorve që ofrojnë këto shërbime.
- Workshope për trajnimin e anëtarëve të këshillave mbikëqyrës të shoqërive ujësjiellës kanalizime, faza e tretë e trajnimeve.

✓ *Pjesëmarrja e ERRU-së në aktivitetet e Sektorit UK*

- Si një aktor i rëndësishëm në sektorin UK, edhe për vitin 2013 kontributi i ERRU-së ka qenë i vlefshëm në aktivitetet e zhvilluara nga MTI në kuadrin e programit "Mbështetje për Sektorin Ujësjiellës Kanalizime" mbështetur nga Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim (ADA) dhe Bashkimi Europian".
- Pjesëmarrje dhe kontribut i veçantë i ERRU në Konferencën Rajonale mbi Menaxhimin e Operatorëve Ujësjiellës Kanalizime organizuar në Tiranë nga SHUKALB në bashkëpunim të ngushtë me Shoqatën Ndërkombëtare të Ujit (IWA). Kjo konferencë ofroi mundësinë për të njohur më mirë e për të ndarë eksperiencën të ndryshme në lidhje me faktorët që ndikojnë në përmirësimin e performancës së operatorve ujësjiellës kanalizime e ndërlidhur kjo me sfidat e ekonomive në zhvillim.
- Pjesëmarrje në Konferencën Kombëtare të Ujit që u zhvillua nga SHUKALB në muajin Nëntor të vitit 2013 ku ERRU, pati rol mjaft aktiv dhe të rëndësishëm përmes prezantimeve dhe drejtimit të disa sesione ku në qendër të diskutimit ishte konsumatori dhe rëndësia e ujit në ditët e sotme.
- Pjesëmarrje në aktivitetin e përvitshëm për shkëmbimin e eksperiencave rregullatore midis ERRU dhe Zyrës Rregullatore për Ujë dhe Kanalizime, Kosovë.

✓ *Bashkëpunimi me Donatorët e Huaj në Shqipëri*

- Bashkëpunimi dhe mbështetja e Qeverisë Gjermane përmes projektit të financuar nga GIZ, prej tashmë 4 vitesh, me objektivin kryesor forcimin institucional të ERRU në sektorin e ujit. Edhe përgjatë vitit 2013, mbështetja dhe konsulenca e GIZ ka konsistuar në përgatitjen e dokumentit bazë të politikave të ERRU si dhe në publikimin e Raportit të Performancës të operatorëve të shërbimit UK për vitin 2012. Gjithashtu ka filluar puna për përgatitjen e planit rregullator të biznesit si dhe për përgatitjen e udhëzuesit për vendosjen e tarifave për operatorët e vegjël.

Nën mbështetjen e GIZ gjatë vitit 2013 pranë zyrave të ERRU është instaluar një server i ri dhe aksesore të tjerë ndihmës që do të bëjnë të mundur dërgimin e shpejtë dhe periodik të të dhënave nga ana e shoqërive ujësjellës kanalizime dhe analizën e tyre nga ana e ERRU-së në kuadër të përmirësimit të cilësisë së shërbimit dhe performancës së Operatoreve të shërbimit UK.

- Bashkëpunimi me **USAID** përmes programit të tij për qeverisjen vendore është zhvilluar faza e tretë e Trajnimit të Këshillave Mbikëqyrës si organi mbikëqyrës i shoqërive ujësjellës kanalizime nëpërmjet një manuali të përditësuar me zhvillimet e sektorit të ujit.

- *Bashkëpunimi i ERRU me Institucione Ndërkombëtare dhe Rregullatore*

Gjate vitit 2013, Enti Rregullator i Ujit ka bashkëpunuar me një sërë institucionesh dhe rregullatorësh ndërkombëtarë që operojnë në sektorin e Ujit si më poshtë:

- Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, OECD
- Banka Botërore (Programi i Danubit për Ujin)
- Shoqata Ndërkombëtare e Ujit, IWA
- Shoqata Kombëtare e Komisionerëve të Shërbimeve Rregullatore, NARUC, USA
- Zyra Rregullatore për Ujë dhe Kanalizime, Kosovë
- Enti Rregullator për Shërbimet e Ujit dhe Mbetjeve, Portugali
- Komisioni Shtetëror Rregullator për Ujin dhe Energjinë, Bullgari
- Komisioni i Shërbimeve Publike, Letoni
- Komisioni Kombëtar Shtetëror i rregullimit të Shërbimeve Publike, Ukrainë
- Autoriteti Kombëtar Rregullator për Shërbime Bashkiake, Rumani
- Autoriteti për Energjinë Elektrike, Gazin dhe Sistemin Hidrik, Itali

- ✓ *Bashkëpunimi me Organizatën për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim OECD*

Enti Rregullator i Ujit, në vitin 2013 u bë pjesë e Rrjetit të Rregullatorëve Ekonomik të krijuar në kuadrin e projektit të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim(OECD) “Aplikimi i një Rregullatori më të mirë në sektorin ujësjellës kanalizime”. Pjesëmarrja në këtë rrjet për ERRU do të thotë vrojtim të eksperiencave të ndryshme rregullatore që do të vënë në dukje sfidat e ardhshme për tu ndërmarrë në forcimin e efektivitetit të ERRU-së.

- ✓ *Bashkëpunimi për Programin e Danubit për Ujin*

Enti Rregullator i Ujit është një nga përfituesit në Programin e Danubit për Ujin mbështetur nga Banka Botërore, Shoqata Ndërkombëtare e Operatoreve ujësjellës kanalizime të zonës së Danubit dhe nga Qeveria Austriake.

Ky programi fokusohet dhe mbështet 11 shtete në rajonin e Danubit në pesë shtylla kryesore siç janë struktura dhe qeverisja në sektor, rregullatori, tarifatat dhe subvencionet, benchmarking, menaxhimi i aseteve si dhe përmirësimi i efektshmërisë së shërbimit. Nën frymën e këtij programi janë organizuar disa workshope. I pari u realizua në Vienë, Austri ku u bë promovimi dhe identifikimi i nevojave të mëtejshme që do të siguroj ky program për Sektorin Ujësjellës Kanalizime në çdo vend të rajonit. Me pas, në dy workshope të tjera në

Bukuresht te Rumanise dhe në Firenze te Italise për Benchmarkun dhe përcaktimin e objektivave konkrete të politikave në sektor.

✓ *Aktivite dhe Trajnime Ndërkombëtare*

- Pjesëmarrje në Forumin "WASH Sustainability" të organizuar nga Banka Botërore me tematikë kryesore "Zhvillimet e shërbimeve të ujit, kanalizimeve dhe higjenes për vendet në zhvillim.
- Pjesëmarrje në Samitin Botëror të Ujit në Hungari i cili theksoi rëndësinë e zgjidhjeve të arritshme të sfidave të Sektorit Ujësjiellës Kanalizime shumë aktuale edhe të nevojshme edhe për sektorin UK në Shqipëri.
- Pjesëmarrje e perfaqesuesve të ERRU gjatë vitit 2013 në dy trajnime të zhvilluara në SHBA mbi rolin, përgjegjësitë dhe Detyrat e Besueshmërisë të Komisionerëve Rregullatorë duke përfshirë metodat e reja, prespektivat apo mjetet e duhura drejt vendimmarrjes rregullatore.
- Në frymën e njohjes së eksperiencave të ndryshme rregullatore por edhe në vendosjen e kontakteve me rregullatorë rajonalë me qëllim bashkëpunimin në të ardhmen, perfaqesuesit e ERRU ka marrë pjesë në dy workshope ndërkombëtare të organizuara nga Shoqata rajonale rregullatore e energjisë (ERRA) dhe Shoqata Ujësjiellës Kanalizime të Rumanisë në fokus të së cilave janë diskutuar zhvillimet, eksperiencat dhe praktikat rregullatore në sektorin e Ujit në rajon.
- Pjesëmarrje në seminarin e dytë për Rregullimin e sektorit të ujit në Europë. Seminari u organizua nga Universiteti i Firences si dhe Universiteti I Sorbones. Në seminar u bënë prezantime nga të gjithë pjesëmarrësit mbi ceshtje rregullatore të sektorit të ujit.

1.4 Të ardhurat dhe shpenzimet e ERRU

• *Burimet e financimit të veprimtarisë*

Burimet e financimit të aktivitetit të veprimtarisë së ERRU përcaktohen në ligjin nr.8102, datë 28.03.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit të perpunimit të ujërave të ndotura" dhe janë pagesat rregullatore, pagesat nga licencimet dhe donacionet.

ERRU është institucion i pavarur që nuk financohet nga buxheti i shtetit, por nga të ardhurat e realizuara nga veprimtaria e tij.

Për vitin 2013, të ardhurat totale të realizuara nga burimet e financimit, janë në shumën 21 483 mijë lekë, 17 801 mijë lekë më pak se të ardhurat e realizuara në vitin 2012. Të analizuara sipas burimeve të financimit të ardhurat e vitit 2013, rezultojnë të jenë:

- 20 405 249 lekë nga pagesat rregullatore;
- 610 000 lekë nga pagesat për licencimet;
- 467 692 lekë të ardhura të tjera.

Edhe gjatë këtij viti, financimi i disa aktiviteteve dhe veprimtarive të Entit ka patur mbështetjen financiare të GIZ.

Niveli i ulët i likuidimit të pagesave rregullatore nga operatorët që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorin UK është ndër shkaqet kryesore që me të ardhurat e realizuara këtë vit, nuk garantuam tërësisht mbështetjen financiare për mbulimin e shpenzimeve vjetore të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit të Entit. Niveli i likuidimit të pagesave rregullatore gjatë këtij viti është shumë i ulët, krahasuar si me vlerat e kontraktuara ashtu dhe me nivelin e likuidimit në vitet e mëparëshme.


- *Shpenzimet operative*

Plani vjetor i shpenzimeve operative të rregullatorit për vitin 2013, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, (i ndryshuar), mbas paraqitjes së tij për miratim nga ERRU, është miratuar me VKM nr. 815, datë 21.11.2012, "Për miratimin e fondit të shpenzimeve, të Entit rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura për vitin 2013"

Komisioni Kombëtar Rregullator në përputhje me nevojat e institucionit për përmbushjen e objektivave vjetore të tij detajoi planin vjetor të shpenzimeve operative, të miratuar nga Këshilli i Ministrave. Në hartimin e planit vjetor të shpenzimeve, Enti kushtëzohet nga mundësitë për garantimin e financimit të tij, pasi financimi realizohet tërësisht nga të ardhurat e vetë rregullatorit që janë pagesat rregullatore dhe ato të liçencimit. Sigurimi i financimit bëhet problematik për shkak të nivelit të ulët të likuidimit të pagesave rregullatore nga operatorët, ndërkohë që zgjerimi i aktivitetit dhe veprimtarisë së Entit në përmbushje të masave të përcaktuara në Strategjinë Sektoriale të Sektorit UK, dhe të realizimit të objektivave të vetë rregullatorit, kërkon mbështetje financiare duke reflektuar rritje në shpenzimet vjetore të institucionit.

Në total, plani vjetor i shpenzimeve operative të ERRU për vitin 2013 ka qenë në shumën prej **44 103 000 lekë** dhe i detajuar në zëra është si më poshtë:

Grafiku 7: Plani vjetor i shpenzimeve operative



Paga dhe shpërblime	23,183,000 lekë
Sigurime shoqërore	2,836,000 lekë
Shërbime e furniturë	12,000,000 lekë
Investime	6,084,000 lekë

Në zbatim të VKM nr. 591, datë 10.07.2013, " Për disiplinimin e shpenzimeve buxhetore në vitin 2013", edhe në planin vjetor të Entit u bënë ndryshimet përkatëse të fondeve të miratuara në përputhje me vendimin në fjalë që patën influencën e tyre në realizimin e planit.

- **Realizimi i shpenzimeve**


Shpenzimet buxhetore për ushtrimin e aktivitetit e veprimtarisë vjetore të Entit janë në shumën 34 579 886 Lekë.

Nga këto:

- 21 227 238 Lekë, shpenzime për pagat e punonjësve.
- 2 801 618 Lekë, shpenzime për sigurime shoqërore të punonjësve.
- 9 506 706 Lekë, shpenzime të kryera për shërbime e furniturë.
- 1 044 324 Lekë, shpenzime për investime.

Në grafikun e mëposhtëm, zërat e planit të shpenzimeve jepen të pasqyruar krahasimisht me planin e miratuar.

Grafiku 8: Plani i shpenzimeve sipas zërave



Përdorimi i fondeve të planifikuara është bërë në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi si për trajtimin me paga e shpërblime të punonjësve, ashtu dhe për blerjet e mallrave e shërbimeve të ndryshme. Po kështu, është ndjekur në vazhdimësi edhe përmbushja e detyrimeve kontraktuale për mallrat dhe shërbimet e ndryshme duke kryer njëkohësisht në kohë edhe pagesat përkatëse. Si rrjedhojë rregullatori nuk ka mbartur shpenzime të pashlyera nga viti 2013.

Fondi i pagave e shpërblimeve është realizuar në masën 91.56 përqind të fondit të planifikuar, ndërsa sigurimet shoqërore në masën 98.76 përqind. Diferenca në këta dy zëra është si rezultat i mosplotësimit të një funksioni në organikë për periudhën 1 vjeçare.

Fondi i planifikuar në zërin “Shërbime e furniturë” është realizuar në masën 79.4 përqind. Me këto fonde, gjatë vitit 2013, janë siguruar kushtet e mjetet optimale të punës si dhe një bazë materiale e domosdoshme për përmbushjen e detyrave funksionale të ERRU. Shpenzimet në zërin “Investime” janë realizuar në masën 17 përqind të planit.

Theksojmë se në mosrealizimin sipas planifikimit të këtyre dy zërave të shpenzimeve kanë ndikuar jo vetëm reduktimi i fondeve nga VKM nr. 591, datë 10.07.2013, por edhe niveli i ulët i likuidimit të pagesave rregullatore nga operatorët gjatë vitit si burimi kryesor i financimit dhe mbulimi i disa shpenzimeve nga projekti GIZ. Gjithashtu në zërin investime ishin parashikuar fonde për rikonstruksion të pjesshëm në godinën që kemi në përdorim për ushtrimin e veprimtarisë, që nuk u realizuan pasi investitorët e tjerë u tërhoqën. Rikonstruksioni do të realizohej me kontributin financiar edhe të institucioneve të tjera si ERRE, OST me të cilët kemi në përdorim të njëjtën godinë.

- *Pagesa rregullatore vjetore*

Detyrimi vjetor i konstatuar për pagesat rregullatore për vitin 2013, mbështetur në kontratat përkatëse, është në shumën 61 916 710 lekë. Kjo vlerë përfaqëson detyrimin e pagesave rregullatore për 42 operatorë, të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në sektor dhe kanë kontratë të nënshkruar me Entin për pagesën rregullatore.

Pavarësisht vëmëndjes së veçantë që i është kushtuar gjatë vitit problemit të pagesave rregullatore, likuidimi i tyre rezulton të jetë në nivel shumë të ulët. Janë likuduar gjatë vitit vetëm 20 405 249 lekë, vlerë kjo afro 40 milion lekë më e vogël se vlera e kontartuar me operatorët që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorin UK. Për funksionimin dhe zhvillimin e aktivitetit vjetor të rregullatorit shpenzimet buxhetore janë në shumën 34 579 886 lekë, prej të cilave vetëm 20 405 229 lekë janë mbuluar me likuidimet gjatë vitit të pagesave rregullatore.

Pagesa rregullatore e kontraktuar me operatorët mbulon tërësisht planin e shpenzimeve operative të Enti, por është niveli i ulët i likuidimit të tyre që vit pas viti nuk mbulon plotësisht planin e shpenzimeve operative vjetore, sipas miratimeve të Këshillit të Ministrave.

Rregullatori gjatë vitit ka analizuar herë pas here problematikën e pagesave rregullatore, ka kërkuar vazhdimisht korrektësinë dhe mirëkuptimin e operatorëve për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale për përmirësimin e kësaj situate.

Pagesa rregullatore, ose detyrimi për tu paguar nga operatorët është mesatarisht 0.8% e të ardhurave vjetore të përlogaritura për tu përfituar me tarifat e miratuara.

Operatorët me vlerat më të larta të pashlyera të pagesave rregullatore janë: "UK Tiranë" sha me 33 902 000 lekë, "UK Durrës" sha me 18 197 900 lekë, "UK Vlorë" sha me 5 000 000 lekë, "UK Kavajë" sha me 4 825 000 lekë, "UK Fier" sha me 4 100 000 lekë, "UK Berat-Kuçovë" sha me 2 385 880 lekë. Në total detyrimi i këtyre operatorëve është në shumën 68 410 780 lekë. Kjo shifër krahasuar me detyrimin e pashlyer në total përbën 75.45 % të tij.

2. Gjendja në sektorin e Shërbimeve UK

2.1 Pronësia e operatorëve dhe shërbimet e ofruara

- *Pronësia*

Sektori i shërbimeve UK funksionon kryesisht nëpërmjet operatorëve të organizuar si shoqëri aksionare me pronar pushtetin vendor. Pas miratimit të ligjit nr.8652, date 31.07.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar, sistemet e furnizimit me ujë filluan të transferohen te njësitë vendore, nëpërmjet disa vendimeve të Këshillit të Ministrave në vitet 2004 dhe 2006.

Vendimi më i rëndësishëm dhe që përmbylli transferimin e aksioneve të operatorëve UK nga qeveria qendrore drejt njësite vendore ishte vendimi i Këshillit të Ministrave nr.660 datë 12.09.2007 "Për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjellësve dhe kanalizimeve njësite të qeverisjes vendore". Me këtë vendim 47 operatorë shërbimesh UK kaluan pranë njësite vendore përkatëse. Në rastet kur shoqëria UK mbulonte më shumë se një njësi të qeverisjes vendore, aksionet e saj u ndanë në përpjestim të drejtë me numrin e popullsisë së asaj njësie, që mbulohej nga shoqëria UK.

Megjithatë, problematikat që shoqëruan këtë proces, bënë që transferimi efektiv i të gjithë operatorëve pranë njësite vendore të zgjatej në kohë.

Ndër këto problematika mund të përmendim mungesën e dakortësisë me njësitë vendore për formën dhe mënyrën e transferimit të operatorve, transferimi në bllok i operatorëve, pa analizuar situatën e secilit operator, mos regjistrimi i aseteve, etj.

Aktualisht disa operatorë ndër të cilat operatorë si "Elber" sh.p.k (Elbasan), "U Rubik" sh.a, dhe Ndërmarrja "U Gjirokastër Fshat" ende nuk e kanë përmbyllur procesin e transferimit pranë njësite vendore.

- *Shërbimi i ofruar*

Në sektor veprojnë gjithsej 58 operatorë, por jo të gjithë i ofrojnë të dyja shërbimet ujësjellës dhe atë të kanalizimeve. Njësitë vendore të mëposhtme e kryenin vetë shërbimin e kanalizimit, nëpërmjet sektorëve që i kanë pjesë të strukturës së brendëshme të bashkisë.

- | | | |
|-------------|--------------------|-------------------|
| 1. Bulqizë | 7. Peshkopi | 13. Kurbin |
| 2. Bilisht | 8. Përmet | 14. Vau i Dejës |
| 3. Delvinë | 9. Patos | 15. Vlorë |
| 4. Gramsh | 10. Orikum | 16. Polican |
| 5. Has | 11. Novoselë | 17. Ura Vajgurore |
| 6. Çorovodë | 12. Malësi e Madhe | 18. Bajram Curri |

Ky fragmentarizim i shërbimeve nuk i shërben cilësisë së shërbimit dhe qëndrueshmërisë financiare të operatorve të ujësjellsave. Për këto arsye, ERRU në fillim të vitit 2013 kërkoi nga njësitë e mësipërme të realizonin bashkimin e të dy shërbimeve dhe ofrimin e tyre nga operatorët e ujësjellsit që operojnë në zonën administrative të njësisë.

Më tej, ERRU e ka ndjekur këtë çështje gjatë gjithë vitit 2013, duke organizuar takime me përfaqësues të njërive vendore. Deri më tani 5 njësi vendore, nëpërmjet vendimarrjes përkatëse në këshillat bashkiakë, transferuan shërbimin e kanalizimit pranë operatorve të ujësjellsave në zonë. Këto bashki janë:

- Bashkia Orikum
- Bashkia Peshkopi
- Bashkia Delvinë
- Bashkia Bilisht
- Bashkia Vlorë

Këtyre bashkive ju shtohet edhe Bashkia Tepelenë e cila e ka transferuar këtë shërbim pranë operatorit të ujësjellsit në fund të vitit 2012.

Ndërkohë janë në proces për bashkimin e të dy shërbimeve Bashkia Patos dhe Përmet, të cilat mendohet të përfundojnë kalimin e shërbimit të kanalizimeve pranë operatorëve të ujësjellsit në tremujorin e parë të vitit 2014.

Ky proces do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2014, me qëllim që të gjitha njësitë vendore të përmendura më lart të realizojnë kalimin e shërbimit të kanalizimeve nën përgjegjësinë e operatorëve të ujësjellsit.

Gjatë këtij viti, ky proces do të përfshijë edhe ato njësi vendore të cilat shtrihen në zonat e shërbimit të operatorëve të tillë si Shoqëria "Ujësjells Lushnje Fshat" sh.a, "Ujësjells Shkodër Fshat" sh.a, "Ujësjells Elbasan Fshat" sh.a, "Ujësjells Korçë Fshat" sh.a, "Ujësjells Pukë Fshat", etj.

Gjatë ndjekjes së këtij procesi dhe komunikimit me njësitë vendore, ERRU konstaton se shpesh stafet përkatëse të bashkive nuk e njohin kuadrin ligjor në fuqi dhe detyrimin për një shërbim të licencuara dhe me standarte. Njësitë vendore i referohen gjithmonë ligjit të tyre organik, dhe në kuadër të tij i kanë organizuar shërbimet e kanalizimit si sektorë brenda bashkisë, ndërkohë që situata ligjore është shumë e qartë.

Gjithashtu në disa raste vihet re edhe mungesa e dëshirës për bashkimin e këtyre shërbimeve, pasi operatorët e shërbimit të ujësjellsit konsiderohen jashtë përgjegjësisë të kryetarëve të njërive vendore dhe kalimi i kanalizimeve të këta operatorë mendohet si heqje e kompetencave të tyre. Në disa raste të tjera, operatorët e shërbimit kanë probleme financiare dhe bashkimi i shërbimeve mund të rezultojë në shtimin e problemeve të tyre.

2.2 Mbulimi me shërbime ujësjellës e kanalizime

Shërbimi i furnizimit me ujë dhe kanalizime aktualisht ofrohet nga 58 operatorë. Nga këta, 32 operatorë ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime ndërsa 26 operatorë kryejnë vetëm shërbimin e furnizimit me ujë. Enti Rregullator i Ujit bën përpjekje maksimale që shërbimi ndaj konsumatorëve të jetë gjithnjë e më cilësor, i ofruar nga operatorë të licencuar, me tarifa të miratuara prej Entit, duke patur gjithnjë në vëmendje konsumatorin. Popullsia që jeton në zonat urbane ka më shumë akses në këto dy shërbime ndërsa ajo rurale ka akses më të madh në furnizimin me ujë.


Numri total i popullsisë që jeton në zonën e juridiksionit të operatorëve është 3,217,023 banorë nga të cilët 2,572,755 banorë ose 80.8 % e tyre ju ofrohet shërbimi i furnizimit me ujë dhe 51.0 % e tyre i ofrohet edhe shërbimi me kanalizime i cili vazhdon të mbetet prapa atij të furnizimit me ujë në shumë aspekte. Popullsia që i ofrohet shërbimi me kanalizime jeton kryesisht në zonat urbane të vendit (afro 98% e popullsisë së shërbyer), ndërsa popullsia në zonat rurale pothuajse është lënë jashtë këtij shërbimi. (detajet jepen në hartën e mëposhtme)




Cilësia e shërbimit me kanalizime dhe mbrojtja e mjedisit është përmirësuar për 10 % të popullsisë në zonën e juridiksionit të operatorëve si rezultat i vënies në punë të 5 impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura. Ndërkohë të tjerë impiante janë në ndërtim e në projektim (detajet jepen në Ankesin nr.3).

Për popullsinë jashtë zonave të juridiksionit të operatorëve, shërbimi ofrohet nga sektorë që veprojnë brenda njësisive të qeverisjes vendore, komunave dhe bashkive që nuk janë të licencuar nga ERRU.

Në nëntor të vitit 2013, Enti Rregullator i Ujit filloi një studim kombëtar mbi të gjitha zonat e pambuluara me shërbim ujësjellës kanalizimesh të licencuar. Këto zona përfshijnë kryesisht njësi të vogla të qeverisjes vendore (128 komuna dhe 3 bashki) të cilat e ofrojnë vetë shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në zonën e tyre të juridiksionit. Kjo çështje ka përbërë gjithmonë një shqetësim për ERRU, pasi përfshin atë pjesë të popullsisë e cila merr shërbim UK të palicencuar dhe me tarifa të pamiratuara nga ERRU.

Më konkretisht ky studim përfshin evidentimin e saktë të zonave të pambuluara me shërbim të licencuar nga operatorët UK, mbledhjen e të dhënave të një spektri të gjerë, teknike, financiare dhe menaxheriale dhe analizimin e tyre, analizimin e informacionit cilësor që do të merret në terren, për të arritur në hartimin e një raporti me të dhëna të detajuara dhe rekomandime konkrete mbi hapat që duhen ndërmarrë për thjeshtimin e procedurave për licencimin dhe rregullimin në përgjithësi të shërbimit ujësjellës kanalizime të ofruar në këto zona. Ky studim pritet të përfundojë në fund të 6 mujorit të parë të vitit 2014.

HARTA E MBULIMIT ME SHËRBIME UJËSJELLËS DHE KANALIZIME**LEGJENDË**


-  Operatorët që ofrojnë shërbim ujësjellës
-  Operatorët që ofrojnë shërbim ujësjellës kanalizime
-  Zonat e pa mbuluara me shërbim UK nga operatorët

2.3 Kostot për shërbimet ujësjellës e kanalizime

Një nga treguesit kryesorë që bën të mundur vlerësimin e situatës financiare të një operatori është “Mbulimi i Kostove O&M”. Mbulimi i kostove të drejtpërdrejta O&M (pa amortizimin) me të ardhurat nga aktiviteti, shërben si bazë për të siguruar qëndrueshmëri në ofrimin e shërbimeve ujësjellës kanalizime. Në vitin 2013, ky tregues ka arritur nivel shumë të mirë në shkallë sektori, 112.4%, duke përmbushur kështu objektivin e Strategjisë Sektoriale që në vitin 2013 mbulimi i kostove O&M me të ardhurat e realizuara të jetë në masën 100%.

Mbulimi kostove O&M përbën hapin e parë drejt mbulimit të plotë të kostove në të ardhmen. Gjatë vitit 2013, 9 operatorë aplikuan tarifa të reja dhe për rrjedhojë rritja e të ardhurave të tyre ka ndikuar në mbulimin e kostove O&M. Vendimet e marra nga ERRU lidhur me ndryshimet e tarifave për këta operatorë janë shoqëruar edhe me objektiva mbi përmirësimin e cilësisë së shërbimit. Nga të dhënat rezultojnë se janë 20 operatorë që mbulojnë mbi 100% kostot e operimit mirëmbajtjes.

Grafiku 9: Mbulimi kostove me të ardhura



Mbulimi i kostove totale (kostot operim dhe mirëmbajtje plus amortizimin dhe kostot kapitale, dmth interesi/shlyerja e huave) me të ardhurat e realizuara nga veprimtaria kryesore dhe nga shërbimet e tjera është objektivi kryesor i çdo operatori. Bazuar në strategjinë e sektorit, ky objektivi do të arrihet gradualisht, duke filluar së pari me mbulimin e kostove operative dhe mirëmbajtjes (O&M). Në vitin 2013, mesatarja për mbulimin e kostos totale për sektorin është 84% nga 76% që ishte në vitin 2012. Kjo do të thotë që operatorët po punojnë seriozisht për arritjen e këtij objektivi edhe pse ende mbetet shumë për të bërë. Gjatë vitit 2012, 6 operatorë kanë mbuluar kostot totale mbi 100% dhe fitimi do të ndihmojë në grumbullimin e fondeve të nevojshme për shlyerjen e kredive të marra apo realizimin e investimeve me burime të vetë operatoreve.


Gjithashtu vlen të përmendim se ka ende operatorë, kryesisht operatorë të vegjël, që me të ardhurat e tyre nuk arrijnë të mbulojnë as gjysmën e shpenzimeve që kryejnë.

Mbulimi i kostove për tre grupet e operatoreve është:

	Madhësia e operatorit (nr i lidhjeve ujësjellës)	Mbulimi Kostove O&M	Mbulimi i Kostos Totale
Grupi 1	>15.000	124.0%	92.4%
Grupi 2	3.000 - 15.000	84.0%	65.3%
Grupi 3	<3.000	63.8%	43.1%

Në analizën e strukturës së kostos së shërbimeve vihet re se peshën specifike më të madhe në totalin e shpenzimeve e zënë kostot e punës (personeli) dhe të energjisë elektrike.

Grafiku 10: *Struktura e kostos së shërbimeve UK*



Meqënëse kosto e punës është një nga zërat me peshën më të madhe në kostot O&M dhe koston totale, efica e stafit bëhet një nga treguesit me rëndësi të veçantë. Për vitin 2013 ky tregues ka shënuar një rritje të vogël krahasuar me një vit më parë duke arritur nivelin e 9.5 punonjës për 1 000 lidhje.

Përgjithësisht operatorët UK kanë numër të lartë punonjësish për 1000 lidhje që tregon për një menaxhim jo efikas të burimeve njerëzore. Për një numër të vogël operatorësh niveli i këtij treguesi i përafrohet nivelit të vendeve të rajonit ku numri mesatar i punonjësve për 1000 lidhje nuk është me shume se 4-5 punonjës/1000 lidhje. Përmirësimi i efica së stafit do të ndikojë në nivelin e shpenzimeve për këtë zë.

Për operatorët që administrojnë sisteme me ngritje mekanike si për furnizimin me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura, kosto e energjisë elektrike zë një peshë të konsiderueshme në totalin e kostove. Gjithashtu shpenzimet për energjinë elektrike janë rritur edhe për shërbimin

e largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, sidomos për ata operatorë që administrojnë edhe impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura.

Përmirësimi i efikasitetit të energjisë është një tregues mjaft i rëndësishëm me ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e situatës financiare të operatorëve. Reduktimi i humbjeve si dhe ndërprerja e lidhjeve të paligjshme dhe vendosja e matësave detyrimisht do të sjellë uljen e vëllimit të ujit të prodhuar dhe për rrjedhojë uljen e kostos së energjisë elektrike.

Në sektorin ujësjellës kanalizime janë kryer dhe po vazhdojnë të kryhen investime për rehabilitimin e sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve apo ndërtimin e sistemeve të reja.

Një vend të rëndësishëm zënë investimet për ndërtimin e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura. Burimi kryesor i investimeve mbeten fondet e akorduara nga buxheti i shtetit si dhe kreditë dhe grantet nga donatorët e huaj. Mirëmbajtja e këtyre investimeve si dhe pagesat për koston e kredive për shumë operatorë zënë një vend të rëndësishëm në totalin e kostos, prandaj edhe sigurimi i mjeteve financiare për mbulimin e tyre merr një rëndësi të veçantë.

Burimi kryesor i të ardhurave për operatorët janë të ardhurat e realizuara nga aktiviteti kryesor i tyre dhe shërbimet e tjera që ata kryejnë për konsumatorët.

Edhe gjatë vitit 2013 qeveria ka akorduar subvencione por krahasuar me vitin e mëparshëm ka ulje të tyre. Ky është një sinjal që operatorët duhet të sigurojnë pavarësinë ekonomike dhe të realizojnë të ardhurat për përballimin e shpenzimeve.

2.4 Performanca e operatorëve në shërbimet ujësjellës e kanalizime

Shërbimi i furnizimit me ujë dhe kanalizime në vendin tonë ofrohet nga 58 operatorë. Në zbatim të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, të gjithë ofruesit e shërbimeve UK duhet të jenë të licencuar dhe të aplikojnë tarifa të miratuara nga ERRU. Aktualisht vetëm 2 operatorë nuk janë paisur me licencë dhe 14 nuk aplikojnë tarifa të miratuara nga ERRU.

Një nga detyrat kryesore të ERRU është t'i paraqesë qeverisjes qëndrore situatën aktuale të sektorit. Për këtë arsye ERRU monitoron dhe analizon në mënyrë të vazhdueshme performancën e operatorëve që ofrojnë shërbime ujësjellës e kanalizime dhe atë të sektorit në tërësi. Monitorimi dhe analiza bëhet mbi bazën e Treguesve Kyç të Performancës të miratuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator. Nivelet aktuale të TPK-ve si dhe tendenca e tyre në tre vitet e fundit jepen në tabelën e mëposhtme:

Tabela 4: Treguesit kryesore të performancës⁴

Nr	Treguesit	Njesia	2011	2012	2013	Tendenca
1	Mbulimi me Ujë	%	80.8	80.8	80.8	=
2	Mbulimi me Kanalizime	%	50.8	51.0	51.0	=
3	Mbulimi i Kostove O&M	%	105.2	106.3	112.4	↗
4	Mbulimi i Kostos Totale	%	79.4	82.7	84.0	↗
5	Norma e Arkëtimit	%	79.9	90.9	75.0	↘
6	Niveli i Matjes	%	50.6	55.1	58.5	↗
7	Ujë pa të Ardhura	%	63.5	67.1	68.1	↘
8	Efiçienca e stafit (stafi/1 000 lidhje)	nr	9.3	9.3	9.5	↘
9	Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë	ore/dite	10.9	10.8	11.5	↗
10	Cilësia e Ujit të Pijshëm					
	-Norma e sigurisë klori mbetës				97.7	
	-Norma e sigurisë Koliform				98.0	

Për vitin 2013 treguesit e performancës për sektorin tregojnë se sektori nuk ka performuar mirë në të gjitha drejtimet.

Shërbimi i furnizimit me ujë dhe i kanalizimeve mbetet në të njëjtat nivele. Shërbimi i kanalizimeve vazhdon të mbetet prapa atij të furnizimit me ujë në shumë aspekte. Të dhënat tregojnë se kemi përmirësime, nga 28 operatorë që ofronin më parë këtë shërbim, aktualisht janë 32 operatorë. Trajtimi i ujërave të ndotura kryhet nga 5 operatorë përmes impianteve që janë vënë në funksionim. Gjithashtu tre impiante pritet të fillojnë së shpejti nga puna.

Nevojiten përpjekje të vazhdueshme për të përmirësuar shërbimin e largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura për një pjesë të madhe të vendit, si për sa i përket mbulimit po ashtu edhe nivelit të kërkuar të shërbimit për të mundësuar mbrojtjen e ujërave dhe të mjedisit.

Mbulimi i kostos O&M dhe kosto totale janë tregues me rezultat të mirë dhe tendenca ka qenë pozitive. Numri i operatorëve që kanë arritur të mbulojnë deri në 100% të kostove O&M ka ardhur duke u rritur. Përgjithësisht janë operatorët e mëdhenj që e kanë arritur këtë rezultat, ndërsa operatorët e vëgjël ende lënë për të dëshiruar me nivelin e mbulimit të kostove. Gjatë tre viteve niveli i mbulimit të kostove me të ardhurat nga aktiviteti ka ardhur duke u rritur. Operatorët kanë bërë përpjekje për të mbajtur nën kontroll nivelin e shpenzimeve por nga ana tjetër edhe rritja e tarifave për 13 operatorë në vitin 2012 dhe 10 operatorë në vitin 2013 ka ndikuar në rritjen e të ardhurave.

Por ndonëse rezultatet e mbulimit të kostove me të ardhura janë të mira, për normën e arkëtimit si treguesi kryesor që lidhet me pavarësinë dhe qëndrueshmërinë financiare të operatorëve nuk mund të themi të njëjtën gjë. Ky tregues deri në vitin 2012 ka patur nivel të

⁴ TPK janë përlogaritur në bazë të të dhënave 9 mujore të Njesise së Monitorimit dhe Benchmarkut pranë DPUK për vitin 2013

mirë dhe tendencë pozitive, por në vitin 2013 rezultati nuk është i kënaqshëm. Sektori nuk ka mundur të arkëtojë më shumë se 75% të të ardhurave të realizuara, nga 90% që ka qenë në vitin 2012. Për vitin 2013 puna e operatorëve për grumbullimin e të ardhurave nuk ka qenë në nivelin e duhur. Kjo situatë duhet të tejkalohet, pavarësisht arsyeve objektive dhe subjektive, pasi të gjithë operatorët duhet të kuptojnë se burimi i kryesor i të ardhurave janë të ardhurat e realizuara nga aktivitetit i tyre. Në thelb norma e arkëtimit është një aspekt menaxherial dhe niveli i arritur për këtë tregues shpreh më qartë punën e vetë operatorit.

Një tregues që merr vlerësime pozitive është niveli i matjes. Ecuria e këtij treguesi për sektorin në përgjithësi ka qenë pozitive duke e rritur nivelin mesatar në 58.5% për vitin 2013. Niveli i këtij treguesi po rritet nga një vit në tjetrin. Krahasuar me vitin 2011 niveli i matjes në vitin 2013 është rritur 8%. Ky tregues i ndihmon operatorët të operojnë me të dhëna të sakta në lidhje me sasinë e prodhuar, faturuar dhe të ardhurat që do të gjenerohen nga ky faturim.

Për ERRU, eliminimi i praktikës së faturimit aforfe që momentalisht mbetet në nivele të larta dhe zbatimi i programeve për instalimin e matësive individual dhe në prodhim duhet të jetë në fokus të punës së operatorëve.

Kjo praktikë do të ndihmojë gjithashtu edhe në përmirësimin e treguesit “uji pa të ardhura”, i cili në ndryshim nga treguesi i mësipërm mbetet në nivele jo të mira. Pjesa më e madhe e ujit të prodhuar, ose 68% e tij, është uje pa të ardhura dhe tendenca e këtij treguesi nuk është pozitive. Edhe pse kontrolli dhe zvogëlimi i humbjeve kërkon kohe dhe investime, ERRU ka theksuar në mënyrë të vazhdueshme se reduktimi i humbjeve duhet të jetë prioritet i punës së operatorëve.

Gjatë vitit 2013, ERRU është duke punuar për të marrë më shumë informacion jo vetëm në lidhje me sasinë e ujit të “humbur” por edhe llojit të këtyre humbjeve. Për këtë arsye është duke u punuar që operatorët të plotësojnë “Bilancin e ujit” si një format i cili do të na japë të dhëna të detajuara në lidhje me nivelin e humbjeve dhe shkaqet e tyre. Por edhe vetë operatorët do të kenë një pasqyrë të qartë në lidhje me sasinë e ujit të prodhuar, faturuar e humbur, vlerësimin e situatës dhe programimin e masave që duhet të marrin për përmirësimin e saj.

Efienca e stafit është tregues i cili nuk ka pësuar ndonjë ndryshim të theksuar, megjithatë tendenca e tij nuk ka qenë pozitive. Numri mesatar i punonjësve për 1000 lidhje është rritur nga 9.3 në 9.5. Niveli i këtij treguesi është i lartë nëse do ta krahasojmë atë edhe me vendet e rajonit. Megjithatë ka edhe operatorë ku efienca e stafit është në nivele bashkëkohore. Ky tregues luan një rol të rëndësishëm në nivelin e shpenzimeve dhe kërkon më shumë vëmendje nga operatorët.

Vazhdimësia e shërbimit dhe cilësia e ujit të pijshëm janë treguesit kryesorë për vlerësimin e cilësisë së shërbimit ndaj klientëve. Mesatarja e orëve të furnizimit për vitin 2013 është 11.5 orë në ditë. Krahasuar me një vit më parë ajo është rritur me 0.7 orë. Pjesa më e madhe e

klientëve nuk furnizohen në mënyrë të pandërprerë me ujë të pijshëm, vetëm pak operatorë furnizojnë në mënyrë të pandërprerë klientët me ujë të pijshëm siç janë "UK Korçë" sha, "UK Pogradec" sha dhe "UK Librazhd" sha. Mungesa e furnizimit të vazhdueshëm, pavarësisht shkaqeve, ndikon edhe në cilësinë e ujit.

Cilësia e ujit të pijshëm kontrollohet në mënyrë të vazhdueshme nga Instituti i Shëndetit Publik i cili është edhe institucioni përgjegjës. Vlerësimi i cilësisë së ujit të pijshëm i bërë nga Njësia e Monitorimit dhe Benchmarking pranë DPUK bëhet mbi bazën e dy parametrave, Klorit mbetës dhe Koliform. Normat e sigurisë për secilin prej tyre gjatë vitit 2013 janë përkatësisht: 97.7% dhe 98.0%.

Vlerësimi i cilësisë nga ISHP bëhet kryesisht mbi numrin e pikave të ndotura të matura në zonat urbane. Sipas këtij vlerësimi afërsisht 12.5 % të këtyre pikave rezultojnë me probleme me ndotjen e ujit. Ky numër ka rritje në 6 mujorin e dytë të vitit 2013.

ERRU edhe pse nuk është direkt institucioni përgjegjës për monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm e konsideron këtë një nga treguesit kryesorë për të përmbushur mandatin e tij në lidhje me mbrojtjen e konsumatorëve. Për këtë arsye bashkëpunimi me institucionet përgjegjëse për cilësinë e ujit të pijshëm është forcuar gjatë vitit 2013.

3. Objektivat e ERRU për vitin 2014

- Vijimi i punës për licencimin e të gjithë operatorëve në të gjithë territorin e vendit në zbatim të kërkesave të legjislacionit në fuqi si dhe monitorimi i kushteve të reja të licencimit nga të gjithë operatorët që ushtrojnë aktivitetin përkatës në këtë sektor.
- Rishikimi i Tarifave të shërbimit UK në bazë të analizës dhe vlerësimit të treguesve kryesore të performancës të përcaktuar nga KKRR dhe të Metodologjisë së re të tarifave. Gjatë rishikimit të tarifave do të kihet parasysh edhe mbrojtja e konsumatorit përmes zbatimit të direktivave ndërkombëtare për përbalueshmërinë e pagesës së këtij shërbimi nga konsumatorët familjare. Një vëmendje të veçantë do ti jepet edhe përgatitjes dhe venies në zbatim të një metodologjie të posaçme për shqyrtimin e tarifave për operatorët e vegjël si dhe për trajtimin e ujërave të ndotura.
- Monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë së shërbimit dhe çështjeve konsumatore nga ERRU në bazë të analizës së performancës së operatorëve të shërbimit UK. Enti do të analizojë me profesionalizëm performancën e operatorëve dhe do të përmirësojë më tej punën për verifikimin e të dhënave nëpërmjet inspektimit në terren të vlefshmërisë së tyre. Në përfundim të procesit do të hartohet Raporti i Performancës për cilësinë e shërbimit në sektorin UK për vitin 2013 dhe do bëhen prezantimet e rezultateve tek të gjithë aktorët e sektorit të shërbimit UK.
- Njohja dhe evidentimi i problemeve për shërbimin UK në zonat rurale ku ky shërbim nuk mbulohet nga operatorë të licencuar por kryhet nga sektorë përkatës pranë njësive të pushteteve lokale. Në fund të procesit, do të hartohet një raport/ studim në lidhje me gjendjen e këtij shërbimi në këto zona duke dhënë edhe konkluzionet dhe rekomandimet respektive për rregullimin e shërbimit UK .
- Vazhdimi i punës për vendosjen dhe përditësimin e standarteve të shërbimit në sektorin UK duke i dhënë prioritet standarteve në lidhje me mbrojtjen e konsumatorit dhe marrëdhëniet operator-konsumator.
- Monitorimi i vazhdueshëm i Bilancit të Ujit për të gjithë operatorët e këtij shërbimi me synimin e kontrollit të prodhimit, konsumit të ujit, kërkesës për ujë si dhe të humbjeve në sistemet e furnizimit me ujë.
- Nxitja e operatorëve të shërbimit UK dhe në veçanti trupës menaxhuese që ti kushtojnë rëndësinë e duhur çështjes së efikasitetit të energjisë duke patur parasysh rëndësinë që zë energjia elektrike në strukturën e kostos së shërbimit.
- Konsolidimi institucional i ERRU përmes plotësimit të plotë të strukturës së aprovuar të ERRU, trajnimit të stafit dhe rritjes së kapaciteteve profesionale të ekipit të ERRU, zbatimit të rregullores së re të punës së ERRU, aprovuar në fund të vitit 2013. Gjatë vitit 2014 do të vazhdojmë bashkëpunimin e frytshëm me GIZ dhe mbështetjen e

projektit të tyre për forcimin institucional të ERRU. Gjithashtu do mbështetet projekti i Danubit për Ujin për komponentin rregullator në përmirësimin e cilësisë së shërbimit në sektorin UK.

- Gjatë vitit 2014 do të vihet në punë platforma elektronike për grumbullimin dhe analizimin e të dhënave të çdo operatori dhe sektorit në tërësi. Ky sistem do shërbejë si një bazë të dhënash, dhe do të orfojë informacion në kohë reale për të gjithë aktorët e tjerë dhe do të përmirësojë komunikimin me operatorët dhe rritjen e efikasitetit në vendimmarrje.
- Rritja e transparencës së punës së ERRU përmes publikimit të vazhdueshëm të të dhënave dhe vendimeve të KKRR në faqen e internetit të institucionit, publikimit të raportit vjetor dhe raportit të performancës për cilësinë e shërbimit në sektor, organizimit të takimeve të punës për qartësimin e standarteve dhe rregulloreve të hartuara nga ERRU, përmirësimin e punës në lidhje me procesin e trajtimit të ankesave dhe kërkesave të konsumatorit si dhe të komunikimit me aktorët që veprojnë në këtë sektor.
- Mbështetje aktive të programit të Qeverisë si dhe të strategjisë sektoriale në lidhje me reformën në sektor për hartimin e politikave të përshtatshme për përmirësimin e shërbimit UK në mënyrë që të ecet drejt përputhjes me standartet e BE.
- Rritja e bashkëpunimit me të gjithë aktorët e qeverisjes lokale dhe qendrore, donatorët dhe institucionet e huaja, operatorët e shërbimit UK si dhe institucionet dhe shoqatat në mbrojtje të konsumatorit që operojnë në sektorin e shërbimit UK.
- Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe shkëmbimi i përvojave me institucione rregullatore analoge në Europë dhe në botë, si dhe nënshkrimi i marrveshjeve dypalëshe. Në këtë drejtim, ERRU është pjesë e grupit iniciator të krijimit të rrjetit evropian të rregullatorëve.

4. Rekomandime

- *Rekomandime për përmirësime ligjore*

- *Ligji i organizimit dhe funksionimit të Entit Rregullator të Ujit*

Përmbyllja e procesit të ndryshimeve në ligjin 8102. Ky ligj ka nevojë për disa ndryshime me qëllim që ERRU ti përgjigjet më mirë zhvillimeve në sektor. Ndryshimet janë të nevojshme në disa aspekte si e drejta e miratimit të rregullave dhe kriterëve për licencimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në sektor nga vetë ERRU, monitorimin e sektorit, zgjidhjen e ankesave, shtimin e kategorive dhe masave të sanksioneve

- *Ligji për shërbimet ujësjellës e kanalizime*

Sektori i shërbimeve UK është ndoshta sektori i vetëm në Shqipëri që nuk ka një ligj bazë i cili të rregullojë mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tij. Ky boshllëk është plotësuar herë pas herë në mënyrë të pjesshme me akte nënligjore të Këshillit të Ministrave, por kjo ka qënë e pamjaftueshme për ti dhënë sektorit të shërbimeve UK një kornizë të plotë dhe të përshtatshme ligjore. Mungesa e këtij ligji ka sjellë disa mangësi veçanërisht në veprimtaritë në sektor, përcaktimin e të drejtave dhe detyrave për personave fizikë dhe juridikë, si edhe të administratës publike të përfshirë në këtë sektor, modelin e tregut, rregullat e funksionimit të tij, etj. Ky ligj do të integronte të gjitha aktet e shpërndara në kohë dhe do të shmangë paqartësitë, dykuptimësitë dhe interpretimet.

- *Rekomandime për sektorin UK*

- Miratimi dhe zbatimi i Master Planit në sektorin e UK me synim rritjen e aksesit të popullsisë me ujë të pijshëm dhe të sigurt, rritjen e lidhjeve të popullsisë urbane dhe rurale me rrjetet e grumbullimit të ujravë të ndotura, shtimin e orëve të furnizimit me ujë si dhe rritjen e përqindjes së popullsisë së lidhur me sistemet e trajtimit të ujrave të ndotura (veçanërisht popullsinë e zonave bregdetare).
- Vazhdimi i procesit të rajonalizimit në shërbimin UK përmes zbatimit të Strategjisë së sektorit, bashkimit të shërbimeve UK (Aktualisht janë 26 operatorë, kryesisht të vegjël dhe me probleme financiare, që ofrojnë vetëm shërbimin e furnizimit me ujë) si dhe bashkimit të operatorëve të vegjël me operatorët e mesëm. ERRU është e mendimit që procesi i rajonalizimit/agregimit të këtij shërbimi duhet të bëhet me kriterë të qarta dhe të jetë prioritar në reformat që do të ndërmerren në këtë sektor.
- Ulja e nivelit të ujit pa të ardhura përmes një monitorimi të vazhdueshëm të Bilancit të Ujit dhe të elementëve kryesorë që ndikojnë në këto humbje.

- Të rritet niveli i matjes së prodhimit dhe konsumit të ujit. Aktualisht vetëm 7 operatorë kanë instaluar matësa në prodhimin e ujit dhe vetëm 50 % e ujit të konsumuar matet nga operatorët. Gjatë vitit 2014 duhet të përfundojë instalimi i matësave për konsumatorët privatë dhe buxhetorë. Gjithashtu duhet ti jepet prioritet instalimit të matësave në objektet e prodhimit të ujit (stacione pompash dhe vendburimet e ujit të pijshëm).
- Të rritet eficaenca e arkëtimeve me synim rritjen e të ardhurave për operatorët duke siguruar në këtë mënyrë qëndrueshmërinë financiare të tyre.
- Të menaxhohet më mirë puna për zvogëlimin e kostove të shërbimit nga ana e operatorëve.
- Reformë dhe përmirësime në procesin e monitorimit të performancës së shërbimit nga operatorët e sektorit.
- Reformë në procesin e monitorimit të cilësisë së ujit të pijshëm dhe ujrave të zeza që derdhen në trupat ujore të vendit. Në këtë proces kërkohet një bashkëpunim dhe koordinim institucional i të gjithë aktorëve të sektorit si dhe një mbështetje e projektit të filluar nga GIZ.
- Të sigurohet shërbimi i duhur ndaj konsumatorit nga ana e të gjithë operatorëve duke synuar për mbrojtjen e konsumatorit. Operatorët brenda këtij viti duhet të përfundojnë nënshkrimin e kontratave me të treja kategoritë e konsumatorve.
- Operatorët duhet të administrojnë më mirë [ështëjet e lidhura me mbrojtjen e mjedisit sipas standarteve europiane. Vënia në punë e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura në zonat bregdetare (Sarandë, Lezhë, Vlorë) si dhe rritja e kapaciteteve profesionale për përmirësimin e operimit dhe mirëmbajtjes së tyre mendojmë se do të ndikojnë pozitivisht në këtë drejtim. Kostot e këtij shërbimi janë të larta. Një pjesë e këtyre kostove është e arsyeshme që do të mbulohen nëpërmjet tarifave, por mbulimi i kostove totale mund të mos përballohet nga konsumatorët dhe rritja e tarifave do të sjellë efekte negative. Prandaj është e domosdoshme gjetja e mekanizmave të subvencionimit për të mbrojtur konsumatorët dhe njëkohësisht të sigurojë funksionimin e këtyre sistemeve në mënyrë të qëndrueshme.
- ERRU mbështet objektin strategjik të qeverisë për hartimin e planeve të biznesit si mjet për përmirësimin e menaxhimit të brendshëm të operatorëve si dhe planifikimin e monitorimin e investimeve dhe menaxhimit të aseteve. Në zbatim të Metodologjisë për Vendosjen e Tarifave, për operatorët që kanë të miratuar një plan biznesi miratimi tarifave do të bëhet për më shumë se një vit. ERRU mbështetur edhe nga konsulenca e GIZ është duke punuar për hartimin e udhëzuesit përkatës.
- Procesi i mbështetjes së operatorëve përmes dhënies së subvencioneve dhe investimeve duhet të bëhet përmes një bashkëpunimi aktiv të të gjithë aktorëve që veprojnë në sektor duke marrë për bazë edhe kushtet aktuale të këtij shërbimi si dhe mbulimin e kostove O&M dhe ato totale.

Aneksi 1

Treguesit kryesorë të performancës

Nr	Treguesit kryesorë të performancës	Njesia	Sha UK Erseke		Sha UK Gjirokastr		Sha UK Lezhe		Sha UK Puke		Sha UK Korçe		Sha UK Sarandë	
			2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014
Sherbimet UK														
1	Uji pa të ardhura (humbjet)	%	64.4	62.0	70.0	65.0	48.0	47.0	68.0	66.0	26.0	24.0	72.8	70.0
2	Niveli i matjes	%	49.9	75.0	1.0	15.0	64.0	75.0	44.0	70.0	100.0	100.0	68.7	70.0
3	Cilesia e ujit		100	100.0	normal	normal	normal	normal	normal	normal	sh. mire	sh. mire	normal	normal
4	Kohezgjatja e furnizimit	ore/dite	11.8	16.0	3.5	5.0	20	20	9.0	10.0	24.0	24.0	4.5	6.0
5	Eficienta e energjise		2.8	2.6	0.8	0.8	2.56	2.5	-	-	0.8	0.8	0.7	0.7
6	Efikasiteti i stafit	staf/000/lidhje	5.5	5.5	8.7	6.0	6.1	6.0	11.1	10.0	2.4	2.3	3.6	3.6
7	Mbulimi me uje	%	100.0	100.0	91.7	92.0	90.0	90.0	53.0	60.0	100.0	100.0	92.7	94.0
8	Mbulimi me kanalizime	%	100.0	100.0	48.3	50.0	90.0	90.0	53.0	54.0	94.0	94.0	88.0	75.0
9	Perceptimi Rregullator	pike	67.0	100.0			100	100		100.0		100.0		100.0
10	Norma e arketimit	%	88.8	92.0	88.7	91.0	80.0	85.0	83.0	85.0	90.0	91.0	70.0	75.0
A	Mbulimi i kostove O&M	%	80.0	105.0	124.0	142.0	94.0	97.0	75.0	93.0	153.0	170.0	107.0	117.0
B	Mbulimi i kostove Total	%	69.0	90.0	118.0	134.0	70.0	69.0	65.0	80.0	72.0	84.0	68.0	77.0

Aneksi 2

Tarifat aktuale për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e ujëra të ndotur (të dhënat janë rifreskuar në datë 01 Janar 2014)

Lloji i shoqërisë	Emërtimi	Data e hyrjes në fuqi të tarifave	Për Ujin e pijshëm lek/m ³			Tarife shërbimi lek/klient/muaj			Për Ujin e Ndotur lek/m ³		
			F	B	P	F	B	P	F	B	P
Sha UK	Berat - Kuçovë	01/01/2013	42	120	120	100	200	200	10	18	20
Sha U	Bilisht (Devoll)	01/01/2012	38	100	110	50	50	50			
	Bradashesh										
Sha U	Bulqizë	01/01/2013	17	55	75	100	100	100			
Sha U	Burrel (Mat)	01/01/2006	23	60	80				2	4	6
Sha UK	Delvinë	01/06/2008	48	100	100						
Sha U	Divjakë										
Sha UK	Durrës	01/06/2013	58	110	120	100	100	100	35	50	50
Sha UK	Elbasan (Elber)	01/01/2006	38	115	130				8	25	30
Sha U	Elbasan Fshat	01/01/2012	36	110	110	100	100	100			
Sha U	Ersekë	01/01/2014	35	90	110	100	100	100	8	12	18
Sha UK	Fier	01/01/2013	52	100	120	200	200	200	13	16	18
Sha UK	Fushë Arrez										
Sha UK	Fushë Krujë	01/05/2004	28	60	80				6	10	12
Sha UK	Gjirokastrë	01/01/2014	39	112	124	80	80	80	9	14	14
Sha U	Gjirokastrë Fshat	01/07/2010	25	60	60						
Sha U	Gramsh	01/01/2011	32	90	90						
Sha U	Has										
Sha UK	Himarë										
Sha UK	Kavajë	01/07/2010	38	80	100				15	20	20
	Këlcyrë										
Sha UK	Korçë	01/01/2014	65	110	140	120	120	120	34	56	56
Sha U	Korçë Fshat										
Sha U	Krastë	01/07/2007	30	80	100				7	10	15
Sha UK	Krujë	01/06/2007	33	80	80				8	12	12
Sha U	Kukës										
Sha U	Kurbini	01/01/2011	30	80	120	50	50	50			
Sha UK	Lezhë	01/01/2014	58	135	145	200	200	200	18	22	27
	Libohovë										
Sha UK	Librazhd	01/03/2012	38	100	100				13	22	23
Sha UK	Lushnjë	01/01/2013	52	120	130	100	200	200	14	18	20

Sha U	Lushnjë Fshat	01/01/2006	60	70	100						
	Mallakastër										
Sha U	Malësia e Madhe										
Sha UK	Mirditë (Rrëshen)	01/01/2012	30	100	115				10	15	15
Sha U	Novoselë	01/01/2011	33	50	70						
Sha U	Orikum	01/01/2012	25	70	75	100	100	100			
Sha U	Patos										
Sha UK	Peqin	01/07/2010	30	90	100	50	50	50			
Sha U	Përmet	01/01/2013	40	110	120	100	100	200			
Sha U	Peshkopi	01/01/2010	27	65	85						
Sha UK	Pogradec	01/01/2013	22/6 2	37/11 1	37/111	200+ 100	400+ 100	400+ 150	11./33	12./36	12./36
Sha U	Poliçan	01/07/2010	37	80	95						
Sha UK	Pukë	01/01/2014	35	130	140	100	100	100	8	16	16
Sha UK	Pukë Fshat										
Sha UK	Rrogozhinë	01/01/2013	48	90	100	50	100	100	10	12	12
Sha UK	Rubik	01/10/2008	30	70	100				7	10	15
Sha UK	Sarandë	01/01/2014	50	135	135	120	120	120	18	28	28
Sha U	Selenicë	01/07/2010	30	80	100						
Sha UK	Shkodër	01/01/2012	40	110	110	100	100	100	15	20	20
Sha U	Shkodër Fshat	01/01/2012	50	120	120						
Sha U	Skrapar - Çorovodë	01/03/2010	27	80	95						
Sha U	Tepelenë	01/01/2014	33	100	120	90	400	250	12	20	20
Sha UK	Tiranë	01/01/2012	45	120	135	100	100	100	11	30	35
Sha U	Tropojë	01/11/2004	19	60	80						
Sha U	Ura Vajgurore	10/11/2007	40	90	100						
Shpk	Vau i Dejës										
Sha U	Vlorë	01/05/2013	30	60	80	80			11	13	13

F - Klientë Familjar
B - Klientë Buxhetor
Klientë
P - Privat

Aneksi 3

HARTA E IMPIANTEVE TË TRAJTIMIT TË UJRAVE TË NDOTURA

